

HEJZA

Vlora Ademi

KAM KUPTU SE POEZIA T'KTHEN TE VETJA

DISA MENDIME PËR NJË ZHABË TË ZAKONSHME

Letërsia mesjetare, për shembull, duke përfshirë baladat popullore, është plot me një entuziazëm pothuajse gjeorgjian për Natyrën dhe artin e popujve bujqësorë, si qendrat kineze dhe japoneze, gjithmonë rrith pemëve, zogjive, luleve, lumenjve, maleve

George Orwell


Përpara dallëndyshes, para narcisit të egër dhe jo shumë më vonë se lulebora, zhaba e zakonshme përshtendet ardhjen e pranverës sipas mënyrës së saj, duke dalë nga një vrimë në tokë, ku ka qëndruar e varrosur që prej vjeshtës së kaluar, dhe zvarritet sa më shpejtë të jetë e mundur drejt vijës më të afërt të përshtatshme të ujut. Diçka - një lloj dridhjeje në tokë ose, ndoshta, thjesht një rritje prej disa gradësh e temperaturës - i ka treguar se është koha për t'u zgjuar; edhe pse disa zhaba duket se flenë gjatë gjithë kohës ndodh që nganjëherë të humbasin një vit të tèrë - në shumë raste, kam gërmuar në tokë dhe i kam gjetur të gjalla dhe dukeshin goxha mirë, mu në mes të verës.

Në këtë periudhë, pas agjërimit të gjatë, zhaba ka një parnjë shumë shpirtërore, si një anglo-katolik i rreptë në fund të Kreshmës. Lëvizjet i ka të ngadalta, por të saktë, trupi i është tkurrur dhe për dallim me të, sytë duken në mënyrë jonormale të mëdhenj. Kjo e bën të lehtë që ta pikasin, gjë që s'do të ndodhë në një rast tjetër, një zhabë ka syrin më të bukur ndër të gjitha kriesat e gjallës. Është si ari, ose më saktë është si guri gjysmë i çmuar me ngjyrë të artë, të cilin e sheh ndonjëherë në unazat e vulës mbretërore, dhe që mendoj se quhet kriozër.

Disa ditë pasi hyn në ujë zhaba përqendrohet në grumbullimin e forcës duke ngrënë insekte të vogla. Shumë shpejt fryhet sérish në përmisasat normale dhe më pas kalon një fazë ku pushtohet nga ndjesia e firtë se është têrheqës seksualisht dhe joshës. Gjithçka që ai di, të paktën nëse është një zhabë mashkull, është se dëshiron t'i shtrëngojë krahët rrithë diçkaje, dhe nëse i zgjat një shkop, apo edhe gishtin tënd, ai do të kapet pas tij me një forcë të habitshme dhe do të marrë shumë kohë për të zbuluar se nuk është zhabë femër.

Nododh rëdomtë hasësh në masë pa formë prej dhjetë ose njëzet zhabash që rrotullohen vazhdimi në ujë, njëra që ngjitet pas tjetrës pa dallim seks. Megjithatë, gradualisht ata ndahen në çifte, me mashkullin të ulur siç duhet në kurrizin e femrës. Tani mund të dallohen meshkujt nga femrat, sepse mashkulli është më i vogël, më i errët dhe hipën sipër, me krahët të shtrënguar fort rrith qafës së femrës. Pas një ose dy ditësh, vezët vendosen në rrështë vargje të gjata, të cilat mbështillen brenda dhe jashtë kallamishteve dhe shpejt bëhen të padukshëm. Edhe disa javë, dhe uji është i gjallë me masat e fulterëzave të vogla që rriten me shpejtësi, u mbijë këmbët e pasme, pastaj këmbët e përparme, pastaj u del bishti dhe, më në fund, rrith mesit të verës, brezi i ri i zhabave, më të vegjël sesa gishti i madh, por i përsosur në çdo gjë të veçantë, kërcen nga uji për ta filluar lojën nga e para.

E përmend shumnimin e zhabave, sepse është një nga fenomenet e pranverës që më têrheq më shumë, dhe sepse zhaba, ndryshe nga lauresha dhe agulicja, nuk ka pasur kurrë vëmendje të madhe nga poetët. Sidoqoftë, jam më se i vetëdijshtëm që shumë njerëz nuk i pëlqejnë zvurraniqët apo amfibët dhe nuk po sugjeroj që për ta shijuan pranverën duhet të interesoheni për zhabat. Janë edhe krokusi, mëllëna, goshëla e livadheve, kullumbria etj. Çështja është se kënaqësitë e pranverës janë për të gjithë dhe nuk kushtojnë asgjë. Edhe në rrugët më të ndyra ardhja e pranverës do të shfaqë një shenjë ose një tjetër, edhe sikur me vetëm një blu më të ndezur midis tymtarëve ose e gjelbra e gjallë e një shtogu



gë mbin në një vend më të thatë. Në të vërtetë, është e jashtëzakonshme se si Natyra vazhdon të ekzistojë jozyrtarisht, si dikur, mu në zemër të Londrës. Kam parë një fajku duke fluturuar mbi një fabrikë në Deptford dhe kam dëgjuar një performancë të klasës së parë nga një mëllënjë në Justën Roud. Duhet të ketë disa qindra mijëra, nëse jo me miliona zoj që jetojnë brenda një rrezeje prej katër mijesh dhe është gjë e bukur të mendosh që asnjëri prej tyre nuk paguan asnjë gjysmë qindarke përgirani.

Për sa i përket pranverës, as rrugët e ngushta dhe të zymta rrith Bankës së Anglisë s'mund të mos e ndiejnë. Ajo depërtion kudo, si një nga ato gazrat e rinj helmues që kalojnë nëpër të gjithë filtrat. Pranvera zakonisht quhet "një mrekulli" dhe gjatë pesë apo gjashët vjetëve të fundit kjo metaforë e rraskapitür është ripërtërirë. Pas llojit të dimrave që na është dashur të durojmë kohët e fundit, pranvera duket vërtet e mrekullueshme, sepse është bërë gjithnjë e më e vështirë të besosh se qjo do të ndodhë në të vërtetë. Çdo shkurt, që nga viti 1940, kam menduar se këtë herë dimri do të jetë i përhershëm. Por Persefona, si zhabat, gjithmonë ringjallet nga të vdekuarit në të njëjtën kohë. Papritur, nga fundi i

marsit, ndodh mrekullia dhe lagjja e varfër në të cilën jetoj unë shndërrrohet plotësisht. Poshtë në shesh voshrat e zeza kanë ngjyrë shumë të gjelbër, gjethet po trashen mbi gështenja, narcisët e egër janë rritur, lulet e murit po lulëzojnë, kapela e policit duket një nuancë e këndshme blu, peshkatarë përshtendet klientët me një buzëqeshje, madje edhe harabat kanë një ngjyrë krejt tjetër, pasi kanë ndier efektin shérshes të ajrit, janë bindur të bëjnë një dush, i pari që nga shtatori i kaluar.

A është gjë e keqe të gjesh kënaqësi te pranvera dhe ndryshimet e tjera stinore? Për ta thënë më saktë, a është politikisht e dënueshme, ndërkokë që ne të gjithë rënkojmë, apo gjithsesi duhet të rënkojmë, nën prangat e sistemit kapitalist, të theksojmë se jeta shpesht ia vlen të jetohet për shkak të këngës së mëllënjës, të një vidhi të verdhë në tetor, apo ndonjë dukturë tjetër natyrore që s'kushusur para dhe nuk kanë atë që redaktorët e gazetave të majta e quajnë pikëpamje klasore? Nuk ka dyshim se shumë njerëz mendojnë kështu. E di nga përvaja se një referencë e favorshme për "Natyren" në një nga artikujt e mi mund të më sjellë letra fyese dhe megjithëse fjala mbizotëruesh në këto letra është zakonisht "sentimentale", dy ide duket se janë të

përziera në to. Njëra është se çdo kënaqësi që na jepin proceset jetësore nisin një lloj paqëtimi politik. Njerëzit, kështu mendohet, duhet të jenë të pakënaqur, dhe detyra jonë është t'i shumëfishojmë dëshirat tonë dhe jo thjesht ta rrisim kënaqësinë tonë për gjërat që tashmë kemi. Ideja tjetër është se kjo është epoka e makinave dhe se të mos e pëlgesh makinën, apo edhe të duash të kufizosh mbizotërimin e saj, tregon prapambetje, është reaksionare dhe paksa qesharake. Kjo shpesht mbështetet nga pothuajse dashuria për Natyren është dobësi e njerëzve të urbanizuar që nuk e kanë idenë se si është në të vërtetë Natyra. Ata që me të vërtetë duhet të merren me tokën, siç argumentohet, s'e duan tokën dhe nuk tregojnë as interesin më të vogël për zogjtë apo lulet, përvësje në një këndvështrim rrëpështë dobipurës. Për ta dashur fshatin duhet të kesh jetuar në qytet, thjesht të bësh një shëtitje të rastësishme në fundjavë gjatë periudhave më të ngrohta të vitit. Kjo ideja e fundit është dukshëm e rreme.

Letërsia mesjetare, për shembull, duke përfshirë baladat popullore, është plot me një entuziazëm pothuajse gjeorgjian për Natyren dhe artin e popujve bujqësorë, si qendrat kineze dhe japoneze, gjithmonë rrith pemëve, zogjive, luleve, lumenjve, maleve. Ideja tjetër më duket se është e gabuar në një mënyrë më të ndërlikuar. Sigurisht që duhet të jemi të pakënaqur, s'duhet thjesht të gjemjë mënyra për të përfituar sa më mirë nga një punë e keqe dhe, megjithatë, nëse vrashim çdo kënaqësi që marrin prej proceseve jetësore, çfarë lloj të ardhmeje po përgatitim për veten tonë? Nëse një njeri i s'shijon dot kthimin e pranverës, pse duhet të jetë i lumtur në një Utopi që kursen fuqinë punëtore? Çfarë do të bëjë ai me kohën e lirë që do t'i sigurojë makina? Gjithmonë kam dyshuar se nëse problemet tonë ekonomike dhe politike zgjidhen ndonjëherë, jeto do të bëhet më e thjeshtë në vend se të jetë më ndërlikuar dhe se lloji i kënaqësisë që merr njeriu nga gjetja e agulicës së parë do të duket më i madh se lloji i kënaqësisë që merr duke ngrënë një akullore në melodinë e një pianoje. Mendoh se duke ruajtur dashurinë e kohës së fëmijërisë për gjëra të tilla si pemët, peshqit, fluturat dhe - për t'u kthyer në rastin tim të parë - zhabat, njeriu e bën një të ardhme paqësore dhe të mirë pak më të mundshme dhe se duke predikuar doktrinën se asgjë s'duhet të admirohet përvëç çelikut dhe betonit, njeriu thjesht e bën më të sigurt që qeniet njerëzore s'do të kenë asnjë shtegdalje për energjinë e tyre të tepërt përvëç urjetës dhe adhurimit të liderit. Sidoqoftë, që të jetë, pranvera është këtu, edhe në Londrë, dhe ata s'na ndalojnë dot ta shijojnë. Ky është një reflektim që më jep kënaqësi. Si herë kam qëndruar duke parë zhabat që çiftëzohen, ose dy lepuj që bëjnë boks në arën me misëri të ri, dhe kam menduar për të gjithë personat e rëndësishëm që do të më ndalonin ta shijoja këtë nëse do të mundeshin. Por, përfat, ata s'munden. Për sa kohë që nuk jeni të sëmurë, të uritur, të frikësuar ose të mërzitur në një burg ose në një kamp pushimi, pranvera është ende pranverë. Bombat atomike po grumbullohen nëpër fabrika, policia po vërszon nëpër qytete, gënjeshtrat po vërshojnë nga altoparlantët, por toka ende po rrotullohet rrith diellit dhe as diktatorët dhe as burokratët, pavarësish se thellë brenda tyre nuk e miratojnë zhvillimin e këtyre proceseve, ata nuk janë në gjendje t'i pengojnë. (Tribuna, 12 prill 1946)

Përktheu nga origjinali: Granit Zela

Nën thjerrë

PËRÇMIMI INSTITUCIONAL I KULTURËS

Standardet kombëtare për zhvillim kulturor duhet të janë të përbashkëta, pavarësisht ku jetojnë e ku frymojë shqiptarët! Jashtë këtyre standardeve do të kishim diletantizëm, amatorizëm dhe asimilim, do të kishim rrezik potencial për shitje për "kulturë shqiptare" të "turlitavave kulturore" të huaja që do të ishin turp i madh për mbarë Kombin



Nga Avni HALIMI

Nëse i bëjmë një krahasi zhvillimeve të ndryshme shqërore në rapport me zhvillimet kulturore te ne, sakaq do të dilnim te përfundimi se, fatkeqësisht, jemi për t'u vajuar! Nuk mund të thuhet se nuk kemi korniza ligjore për sa i përket jetës së gjithëmbashme kulturore. I kemi, madje janë në harmoni të plotë me kërkuesat ligjore evropiane. Strategjitet e nationale për kulturë, i kemi, janë të mahnitshme në lexim të parë! A kemi mekanizëm kontrollues, mbikëqyrës, motivues, mbi të gjitha, sankzionues, kundër neglizhuesve dhe sabotuesve të këtyre ligjeve dhe strategjive? Janë mijëra e mijëra godina bane-sore, janë qindra mijëra biznese, qindra korporata, qindra institucione shëndetësore, bankare etj. I tërë ky zhvillim në fakt paraqet vetëm "zhvillimin e manipulueshmë", mundësinë e përfitimeve të mëdha të oligarkëve, por edhe mundësinë e përfitimeve shtetërore nga taksat!

Sponsorizim i "limonatave" që shiten për kulturë

Nga ana tjetër, nuk kemi institucione kulturore rishtas të themeluara! Kemi dy-tre teatro private, dy-tre manifestime private, njo dhjetëra shtëpi botuese që përkudjesen për botimin e librit; nuk kemi operë, filarmoni, balet, nuk kemi institucione kërkimore kulturore. Nuk i kemi se përkujtimi i pasurive të fituara pandershëm, nga ndëshkimi i korruptionit dhe përfitimeve të ndryshme në rrugë folijore. Shqipëria dhe Kosova tashmë e kanë edhe Ligjin për sponsorizim të kulturës rinisë dhe sportit, ligje këto që krijojnë përshtypjen se, intanca e shtetarëve tanë është që më shumë të tallen me kulturën se sa ta ndihmojnë! A nuk është ky një përcrim institucional që i bëhet kulturës?! Ky ligj do të duhet të ishte enkas për kulturën, pastaj le të ketë ligje të ngjashme edhe për riniñe dhe sportin etj. Sepse, këto ligje gjithëpërfshirëse, nuk kanë ravijëzuar bie fjala, kufirin në mes të kulturës dhe argëtimi. Së këndejmi, aktivitetet argëtuese-sportive nuk mund të janë jetë kulturore! Ligjet në fjalë, sponsorizuesve të aktivitetave rinore e sportive u njihet zbritja tridhjetë për qind (30%) nga tatinë në fitim. Kurse, për aktivitetet kulturore kjo zbritje prek vetëm njëzet për qindëshin (20%)! Ligj i ngjashëm ekziston edhe në Maqedoninë e Veriut!

Pse nuk kemi sponsorizim të aktivitetave gjurmuese-arkeologjike, të reperitorit të një filarmonie, të një opere, të një baleti, nuk kemi sponsorizim të një shfaqje teatrale, të botimeve ekskluzivisht të talenteve të reja; pse nuk kemi një

ekspositë të sponsorizuar, nuk kemi koloni artistësh, nuk kemi një manifestim letrar gjithëkombëtar! Sepse, të gjitha këto aktivitete janë elitare dhe nuk u krijojnë kurfarë përfitimi sponsorizuesve. Prandaj, sponsorizuesit i kemi të pranishëm më tepër tek estrada argëtuese-zbavitëse, e cila, nuk paraqet kurfarë aktiviteti kulturore. Sepse, një aktivitet i estradës siguron masë të gjerë vizitorësh, ku edhe reklama për donatorin e shëtë më masovike, kurse një ekspositë pikturnash mund të sigurojë maksimumin nga 1000 vizitorë! Një libër mund të vërehet se është donuar, më së shumti nga nja 30-50 lexues dhe, reklamimi i sponsorizusit shkon vetëm tek ky numër i popullit! Sponsorizimi i aktivitetave kulturore, me prioritete të caktuara institucionalisht, do të duhet që "t'i amnistonte" nga tatinet të gjithë subjektet që dëshirojnë të kontribuojnë në jetën e gjithëmbashme kulturore. Shteti ka mekanizma për ta kontrolluar këtë sponsorizim dhe për t'u lehtësuar nga financimi i të gjitha atyre aktivitetave që ndihmojnë nga dashamirë e kulturës! Kjo do të krijojnë një garë nderbiznesore si dhe një koegzistencë të mrekullueshme biznes-kulturë, në interes të zhvillim të gjithëmbashëm shoqëror!

Manipulimet partiake dhe lavdërimet boshe

Ministria e kulturës është një prej dikastereve më të ndjeshme ku për çdo vit "thyhen heshtat" në mes të maqedonasve dhe shqiptarëve. Çuditërisht, ndonëse shqiptarët vazhdimisht "plagosen përvdej", ata vit për vit ndahen të luntur se ia kanë dalë "të plagosën në periferi të organeve vitale"! Në mënyrë triumfaliste do të ngrenë pluhur duke u lavdëruar se ia kanë dalë që të marrin 30, 40, 50, madje dhe 55 për qind nga buxheti i Ministrisë së kulturës! Kurse para fakteve heshtin edhe zotat! Shqiptarët kurrë nuk kanë arritur ta kuptojnë hilën por, gjithnjë kanë shprehur kënaqësinë se, vit për vit arrijnë që ta shtojnë numrin e botimeve të librave! Pas konfliktit të vitit 2001 numri i librave shqip të financuar nga kjo Ministri ka tejkular dyzetëshin dhe, vit për vit janë shtuar nga një nga dy botime më tepër! Më vitin 2011 numri i botimeve ka arritur në 87 tituj, ndërsa, më 2021 le të themi se arritin të botohen rreth 100 tituj! Dhe, gjithnjë, për çdo vit, shqiptarët e Maqedonisë së Veriut kanë konstatuar se diskriminimi kulturor u bëhet pikërisht se Ministria e Kulturës ndanë buxhet më të madh për librin maqedonas se sa për librin shqip! Pastaj, shtrohen ankesat, pas të cilave lejohet botimi edhe i na 4-5 titujeve dhe, sakaq nuk ka më diskriminim kulturor! Shqiptarët e Maqedonisë së Veriut mirëgenien kulturore e kanë matur me numrin e titujve të botuar pa çka që brenda atyre titujve ka antivlera të

turpshme edhe për komunitetet primitive!

Në Maqedoninë e Veriut funksionojnë mbi 60 institucione kulturore, në të cilat punojnë mbi 2100 persona, prej të cilëve, rreth 200 janë shqiptarë, ndërsa rreth 150 pjesëtarë të përkatesive të tjera (turq, romë, boshnjakë, serbë, vllehë, kroatë etj.). Pra, diku rreth 1700 të punësuar nëpër institucionet nacionale kulturore janë maqedonas, të cilët, sikur të paguheshin minimalisht nga 350 euro, do të duhen mbi 7 milion euro në vit! Për shqiptarët e punësuar nëpër këta institucione do të duhet buxhet vjetor prej afër 850 mijë euro! Nga buxheti vjetor prej 3.3 miliard denarë, apo, rreth 55 milion euro për vitin 2021, rreth 16 milion euro shkojnë për transfera të ndryshme, afër 6 milion për blok dotacione, rreth 4 milion euro investime kapitale, rreth 2 milion e gjysmë euro përmallra dhe shpenzime të ndryshme, si dhe rreth 32 mijë euro për rroga për personat me kontratë në vepër dhe përkompensime të tjera. Po ashtu, rreth 800 mijë euro shkojnë për përfshirjen e të rinjve në aktivitet kulturore, përpërfocimën e integrimeve në EU në rrafshin e kulturës si dhe për programin e ri përmbrojtjen e trashëgimisë kulturore. Nga buxheti i përgjithshëm, pra, ikin mbi 36 milion euro ndërsa shqiptarët marrin mezi rreth 1 milion euro. Pjesa tjetër e buxhetit shkon për aktivitetet përealizimin e programit vjetor të kësaj Ministrie. Edhe nga kjo pjesë e buxhetit përealizim të programit, shqiptarët nuk marrin as 10 për qind, kështu që, nga shuma totale shqiptarët nuk marrin më shumë se 3 milion euro ose rreth 5.5 për qind nga buxheti i përgjithshëm!

Me asnjë marrëveshje deri më sot, as me atë të Ohrit, as me ato gjatë formimit të qeverive, nuk është zbutur diskriminimi shovinist që u bëhet shqiptarëve në rrafshin e kulturës. Ndërsa asnjëherë nuk është analizuar kjo çështje, e cila, kryekëpët ka anuar kah zbutja e diskriminimit në përfshirjen e shqiptarëve në administratën shtetërore. Taksapaguesit shqiptarë japid më shumë se sa marrin, përfshirë këtu edhe participantin në larjen e borxheve që autoritetet shtetërore i marrin për shtet dhe për shqipëri! Pa eliminimin e këtij diskriminimi, cilado parti që do të rrahet gjoks se ka bëre shumë për komb, në fakt e ka vetëm marketing idiotik para elektoratit për tia grabitur votën! Ndërsa angazhim i këtë sferë i cilësdo parti është gati se mision i pamundshëm, megjë në programet e tyre nuk gjen njeriu qoftë dy fjali për kulturën! Sepse nuk e kuptojnë as peshën, as rëndësinë dhe as rolin e kulturës kombëtare. Partitë tona, edhe për nja 100 vite të ardhshme do të merren me asfaltim, me kanalizime, me ujësjellës, me "ekologji", sepse, këtu janë paratë, tenderët, mundësítë për vjedhje e për pasurime enorm. Akoma nuk e kanë të elaboruar mundësinë e vjedhjes nga kultura, apo, janë shumë të vetëdijshëm se këtu mund të përballen me njerëzit e kulturës dhe, që në start janë të vetëdijshëm për humbjen e betejës së tyre e cila nuk shkon përtëj angazhimeve "patriotike" për vjedhje!

Një platformë kombëtare për kulturë shqiptare

Në çdo vend jeta e gjithëmbashme e një shoqërie rregullohet sipas akteve normative dhe akteve nënligjore. Kushtetuta është akti monumental i çdo shteti në të cilën bazohet tërë struktura e ligjeve, statuteve, rregulloreve të cilat përbëjnë "binaret" e një shoqërie të shëndoshë e funksionale. Kur u hartua Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë së Veriut,

shqiptarët ishin të përjashtuar nga përfshirja në komisionin amë përpërgatitjen e këtij akti themeltar! U përjashtuan edhe nga hartimi i shumë ligjeve, të cilat, tashmë nuk kishin nevojë për kontributet e interpretimet shqiptare, sepse, gjithçka bazohej në Kushtetutën e miratuar! Megjithatë, falë këmbënguljes së partive politike shqiptare, u arrit të sensibilizohen edhe maqedonasit dhe të pranojnë se në rrugëtimin e shtet-ndërtimit nuk do të mund të janë të suksesshëm pa shqiptarët e këtushëm, sikur nisën t'i përfshijnë edhe shqiptarët por, de jure, vetëm si popull me emrin "20 për qind"! Kjo dukuri do të shtrihet dhe në të gjitha neten e Ligjit për Kulturë, i cili, pa dyshim, bazohet në Kushtetutën e vendit që e rregullon "shtetin maqedonas"!

Shqiptarët si popull, të përjashtuar nga "obligimi shtetëror" i Maqedonisë së Veriut, bëjnë një jetë kulturore e cila, me tepër na del si kopjim diletantesk, si kopje e zbehtë, e kulturës kombëtare që zhvillohet në Shqipëri e Kosovë, më tepër në baza vullnetare se sa të përkrahur nga institucionet shtetërore. Ky mjerim kulturor pa dyshim që i atribuohet politikave mjerane të partive shqiptare të këtij shteti! Se nuk shprehën kurfarë interesimi për kulturën kombëtare këtë më së miri e vërtetojnë "programet" e tyre partiake! Partitë shqiptare në Maqedoninë e Veriut më tepër janë të përkushtuar për ekologjinë, për "arsirimin e shqiptarëve" duke hapur "universitetin" partiake që prodhon diploma për "politikanët" me përgatitje shkollore tetëvjeçare si dhe për ata që janë në gjendje të paguajnë sa t'u kërkohet! Nëpër programet partiake të shqiptarëve të Maqedonisë së Veriut nuk gjen njeriu asnjë "kapitull" që flet për zhvillim dhe jetë kulturor të shqiptarëve të Maqedonisë së Veriut. Mbi të gjitha, ky problem duhet të jetë brengë serioze për qendrat kombëtare të vendosjes përfatim e shqiptarëve, Tirana dhe Prishtina! Akademja e shkencave dhe arteve të Shqipërisë dhe Kosovës, duhet të obligohen të hartojnë platformë kombëtare për zhvillim kulturor që do të ishte segment i patjetësueshëm i programeve partiake të partive shqiptare të Maqedonisë së Veriut dhe gjithandje ku jetojnë ata në viset etnike. Nuk mund të përkrahet nga qendrat shqiptare asnjë parti e cila nuk e ka prioritet zhvillimin kulturor të shqiptarëve duke e kultivuar identitetin kulturor pro-perëndimor! Nuk ka përfshirje në asnjë qeveri e cila nuk garanton themelim të institucioneve nacionale kulturore, konkretisht, për shqiptarët e Maqedonisë së Veriut! Pa dyshim, implementimi i platformave të tilla kombëtare mund të ketë implikime financiare për të cilat "shteti maqedonas" nuk mund të zotohet se mund të krijojë buxhet dedikues. Prandaj, në një plan afatgjatë asgjë nuk do të kushtonte për Shqipërinë dhe Kosovën të kontribuonin me "shuma modeste" në krijuimin e buxhetit për t'u zbatuar platforma kombëtare për zhvillim kulturor të shqiptarëve të Maqedonisë së Veriut! Kujdesi kombëtar e shtetëror sado që mund të duket "utopik", megjithatë, nesër, do të ketë një pjesë të veten që nuk do ta ketë as "ngarkesë", as "ngatëresë", as "tarp", as "hendikep" por, thjesht, një motor shoqëruar në zhvillimin dhe përparimin kulturor kombëtar! Standartet kombëtare për zhvillim kulturor duhet të janë të përbashkëta, pavarësisht ku jetojnë e ku frymojë shqiptarët! Jashtë këtyre standardeve do të kishim diletantizëm, amatorizëm dhe asimilim, do të kishim rrezik potencial për shitje për "kulturë shqiptare" të "turlitavave kulturore" të huaja që do të ishin turp i madh për mbarë Kombin!

Intervistë: Vlora Ademi, poete

KAM KUPTU SE POEZIA T'KTHEN TE VETJA

Sot, pavarësisht argumenteve, të rrallë janë ata që merren mirëfilli me një vepër arti. Që e ndërtojnë nji analizë duke reflektu mbi faktet në mënyrë objektive. Le të skuqen ata që kritikën e kanë zhvendosë nëpër kuleare!, ose edhe më keq, që këtë e bajnë o nga afërsia me autorin, o nga zilia për te, por jo duke e pasë parasysh veprën



Shkelzen HALIMI

Vlora Ademi aktualisht merret me diplomaci kulturore duke udhëhequr dhe zbatuar projekte, e aktivitete kulturore, brenda dhe jashtë Kosovës me organizatën Social Creativity, të cilën ajo e drejtton. Përveç kësaj, ajo ka një punë dytësore si koordinatore, bashkëpunëtore dhe anëtarë e bordit e Festivalit ETNOFEST; koordinatore e disa festivaleve jashtë vendit, si dhe është themeluese e Festivalit të Poezisë REPUBLIKË NË PRISHTINË.

Pos tjerash Vlora shkruan dhe poezi, të cilat janë përkthyer në gjuhën gjermane, angleze dhe arabe dhe janë botuar në antologjitet: PËRTEJ HARRIMIT në Gjermani dhe MAGMA në Kosovë. Ndërsa së fundi Shtëpia Botuese ONUFRI ka botuar edhe librin e saj të parë me poezi KATËRDHETË E PAK.

Në mars të këtij viti poezia e saj "Nuk ta fali mostradhëtinë" është botuar në gjuhën angleze në antologjinë "Loyalty.Walking Into The Unknown" nga Poet's Choice në SHBA. Ka mbaruar nivelin master për Komunikim Masiv.

Aktualisht, përveç rolit të saj si nanë, punës si drejtuese, dhe menaxhere, ajo gjithashtu është edhe trajnere dhe vazhdon të jep kontributin e saj për kauza vetëdijesimi në shoqëri.

HEJZA: Libri i parë i Juaj, vëllimi me poezi, "Katërdhetë e pak", realisht bëri një bujë të madhe, sepse u prit në mënyrë të shkëlqyeshme gjithandje hapësirave shqiptare. Çka është ajo që e bën të veçantë këtë libër.

V.ADEMI: Origjinaliteti. Stili original me të cilin kam ardhë n'katërdhetë e pak.

HEJZA: Ju me një rast keni thënë se poezia është thellësi, e cila thellësi duhet të gërmohet, sepse është pafund. Çfarë keni zbuluar gjatë gërmimit Tuaj?

V. ADEMI: Nuk e di nëse ky gërmim në këtë kohë ka ardhë si ngacmim, apo si dëshirë e kah-motshme, por kam zbulu se përveç që poezia qenka ngjizë bashkë me mua, ajo gjatë gjithë kohës m'ka

grishë pavetdijshtëm, për me u realizu edhe në nji tjetër dimision. Por tash, mbas librit, du me e plotësu veten. Para se me thanë thellësi, kam kuptu se ajo asht edhe tundim, asht brejtje që të nxitë për procese të tjera mandej. Kam kuptu se ajo t'kthen te vetja. Poëzia asht ajo që të ban me njohtë autorin e poezive tua. Veç përmes saj, arrijmë me e zbulu dhe me e prekë apogjeun e shpirtit.

HEJZA: Pse jeni përcaktuar që të shkruani në gëgnishte?

V. ADEMI: Sepse kjo jam unë. Dikush që edhe frymë merr n'gëgnisht. Pse duhet të tjetërsohem tash që jam katërdhetë e pak?! Gëgnishta asht gjuhë e kulluet e poezisë dhe jo vetëm, e cila sot po lavrohet për veçantitë e saj shprehëse, sidomos përlirizmin dhe koncizitetin e saj në varg. Po e vijon fuqishëm traditën e saj të ndërpreme dhe unë, e ndodhun në kësi mjedisi, e kisha ma të lehtë me u shprehë në nji ekspresion ma afër melodizmit gjuhësor të rritjes sime në Prizrenin, historikisht të dallueshëm si qytet i madhi botës shqiptare. Kushtet e reja të

komunikimit dhe zgjanimi i hapësinave me shpalljen e Kosovës shtet sollën zhvleftësimin e përdorimit ekskluziv të standardit. Rranjet e ndërpreme brutalisht të shqipes nxorën llastarë dhe po e zerojnë edhe njihërë çështjen e nji gjuhe vërtetë të përbashkët, këtë herë si mjet i hapësinave kulturore të lira dhe i krijimtarisë së pacentralizuarne.

HEJZA: Keni realizuar aktivitete të shumta në promovimin e vlerave kulturore. A mund të flasim sot përgjizjen e evropianizimit të kulturës shqiptare. Nëse po, atëherë në çfarë niveli e kemi këtë evropianizim dhe në cilat segmente të kulturës mund të haset me qartë?

V. ADEMI: Po. Bile do t'kisha thanë se jam nji diplomatë freelance në fushën e kulturës. Madje madje, deri tani kam ba ma shumë se sa më asht kriju hapësina me ba, në nji terren shumë të kontaminuën nga struktura e komunitetit letrar, e artistik, por edhe nga strukturat udhëheqëse të fushës në fjalë.

Ndërsa për pjesën tjetër të pyetjes,

mendoj se jemi viktumë e mentalitetit të ballkanit dhe ende jemi në fazën para ngjizjes. Kur kjo të ndodhë, atëherë periudha tjetër veçse na gjen duke mendu, e vepru si evropian. Përfshi këtu edhe aspektin kulturor. Ka nji shekull që po e presim çmimin e madh letrar nga i njejtë shkrimtar (gja që do t’më gëzonte), por a thua që për gati nji shekull, nuk doli nji i dytë po kaq i denjë?

Megjithatë HIVE i Blerta Bashollit, ndërkojë parakaloi shumë tepih të kuq të festivaleve prestigjioze ndërkombëtare të filmit.

HEJZA: Sot, si asnijëherë më parë poezinë e kemi me bollëk, ndërsa shumë pak flitet për poezinë. Edhe ata që marrin mundin të flasin, më tepër i përkasin kategorisë së “kritikëve letrar” që ose kurrë nuk e kanë shkruar poezinë ose kurrë nuk janë përpjekur të mësojnë si shkruhet poezia. Në ç’situata të sikletshme e në ç’nivele të delirit kalon shpirti kur krijuesi e nis dhe e përfundon një poesi. Apo poezia vjen vetvetiu, ngjarje pas ngjarje, pas dashurisë, tradhtisë, vdekjes...

V. ADEMI: Mediet onile, aq sa na e kanë lehtësu komunikimin me botën, po kaq na i kanë ngatërru, e kompliku konceptet për artin, kulturën, mënyrën e jetesës.... Si askund tjetër, me ose pavetëdije, shoqnia me të madhe po i shfaqë kompleset e saja nëpërt to. Nji, që ma së shumti bjen në sy, asht publikimi i poezeve. Sa mirë që disa janë kaq të frymëzuem, e i kanë zaptue tana muzat për me krijue orë e çast, por a janë të vetëdijshëm për masën e teprimit!

Përmes poezia asht diçka që vjen natyrshëm. Vjen në nji çast të caktuem, kur gjendja shpirtnore asht e gatshme me ia falë botës nji përjetim sublim të shpërfaqun në formën e saj. Shpirti ka çaste të fshehta trazimi, që e ngacmon o vdekja, o ikja, o tradhëtia, madje edhe mostradhëtia, që asht akoma ma e pafalshme (hahaha!).

HEJZA: A kemi kritikë letrare! Në ç’nivel e kemi mendimin kritik mbi kulturën tonë krijuese, artistike! Sa zë vend materia e estetikës në punën tonë krijuese?

V. ADEMI: Kritika na sygjeron. Tranzicionet bashkëkohore shoqnonre ngrënë pyetje të randësishme në lidhje me atë që mund ose duhet të konsiderohet aktualisht si njohuni relevante ose e vlefshme për kulturën dhe artet. Hulumtimet e fundit kanë tregu se vlerësimi i artit nxit frymëzim, gja që drejt-përdrejt ndikon në performancën krijuese. Mu për këtë fakt, konsideroj se, asnijëherë nuk kemi pasë nivel ma të ulët të kritikës. Sot, pavarësisht argumenteve, të rrallë janë ata që merren mirëfilli me një vepër arti. Që e ndërtojnë nji analizë duke reflektu mbi faktetet në mënyrë objektive. Le të skuqen ata që kritikën e kanë zhvendosë nëpër kuleare!, ose edhe më keq, që këtë e bajnë o nga afërsia me autorin, o



nga zilia për te, por jo duke e pasë parasysh veprën.

Nji arkitekt amerikan thoshte: gjithmonë zgjidhja e problemeve asht e gabuar nëse nuk asht edhe e bukur. Pra edhe vlerësimi i krijimtarisë gjithherë e kërkon gjykimin e së bukurës, sepse kapaciteti ynë krijues nuk do të ishte i mundun pa pjesën estetike. Janë shtylla paralele.

HEJZA: Është një e vërtetë e çoroditur. Letërsia jonë ka shënuar numrin më të madh të antologjive poetike. Vlerësohet janë diku rreth 500 antologji të përpiluara, sajaura e përgatitura në këto 30 vjetët e fundit. Pse bëhen dhe kushi bën antologjitë?

V. ADEMI: Asht koha e zhvillimit të një fenomeni, që për fatkeqësinë e letërsisë, po devijon. Megjithatë nuk mundem me thanë se jam kundër antologjive, por së paku le të kenë nivel. Duhet angazhim serioz. Ka kritere. Ka filtra. Duhet të ketë bazë të qëndrueshme. Dhe, edhe ky si fenomen, koïcidon me rolin dhe ndikimin të cilin kritika e ka. Lakmia për me kanë në qendër të vëmendjes me çdo kusht, po na kushton shumë, tepër shumë si shqoni.

Në shtator të këtij viti do të dalë Antologja me poezitë e poetëve pjesëmarrës të edicionit të pestë të festivalit të poezisë REPUBLIKA. Poëzitë do të botohen në dy gjuhë, shqip dhe anglisht dhe secila nga

to, së pari asht redaktu nga nji studiues i gjuhës shqipe dhe mandej nga nji i gjuhës angleze. Dhe po mendoj se, deri në këtë fazë asht ba nji punë shumë e mire dhe korrekte. Por pavarësisht se pjesëmarrësit janë emna të dëshmuem tashma të letërsisë, ka ndodhë që, më asht dërgu një poesi e Alison Toënsend (poete amerikane), vetëm se e përshtatun sipas mënyrës së poetes që e ka dërgu. Këtë poesi me titull “Gjanat që nuk t’i tregova për abortin” para afër dy vjete, së pari e ka përkthy poetja Vlora Konushevci. Ndërsa, e njajta poesi, nga një poete pjesëmarrëse, më asht dërgu sikur të ishte poesi autentike e saja. Po të mos kishte njohuni dhe kritere, mbasë edhe do të ishte botu poezia e autores amerikane, me emrin e X poetës pjesëmarrëse në fesatival. Këtë ngjarje e mora si shembull konkret, për me tregu se sa, në rradhë të parë e respektojmë veten (poetët), në rradhë të dytë letërsinë, në rradhë të tretë lexuesin (audiencën) dhe të fundit, nji festival që konsideron se i ban nderim me ftesën. Në këtë rast kjo antologji asht pjesë e festivalit dhe do të vazhdohet në këtë formë derisa festivali të ekzitoj, por në rastet e tjera, me ose pa qëllim, shihet se antologjité po përpilohen sipas preferencave personale të përpiluevse, e jo sipas kritereve: qëllimi, tema, struktura, prezantimi, përfaqësimi.

HEJZA: Bashkimi shpirtëror i



shqiptarëve akoma po has në shumë bariera. Shembull konkret është “antologjia” e Rudolf Markut, i cili poezinë bashkëkohore shqipe e “gjen” vetëm te autorët brenda territorit të Shqipërisë. Pse i kemi këto bariera?

V. ADEMI: Për këtë lloj antologje asht folë, e stërfolë tashma. Nuk du me vazhdur me i kushtu vëmendje ma shumë autorit të saj në këtë rast. Ndërsa kur jemi tek barrierat, ato hala nuk i kemi largu brenda për brenda nesh. Hala udhëhiqemi nga ndjenja e superioritetit dhe e xhelozisë. Cila mendje e shnoshë e këtij shekulli mundet me thanë – Kur une shkruj s’di pse shkruejnë të tjerë/tjetrat. Asht absurd i madh që e kam dëgju. Kjo zezonë na ka prekë këtej, e andej territorit. Ma e keqja asht se, pikërisht të tillëve, madje me vetëdije, po u krijohet hapësina e veprimit. Shqipnia pati emna shumë ma përfaqësues për pozitën në të cilën sot asht përpiluesi i “antologjisë” në fjalë, por zgjodhi dike që, fatkeqësish as njohunitë bazë për poezinë bashkëkohore nuk i paska. Dhe këtë na e argumentoi vet ai. Madje madje edhe titulli i konceptit, asht i përkthymë nga një antologji serbe e Miloslav Shutic (1999).

HEJZA: Ambienti ynë letrar, fatkeqësish që moti është kontaminuar me lloj – lloj mbeturina që dukshëm ia kanë zënë frysmin letërsisë së mirëfilltë. Sot kemi më shumë botues se lexues, qarqe të ndryshme “letrare”, kemi mafi letrare, kemi epigonizëm, diletantizëm dhe çka jo tjetër? Vlerat e vërteta u përmbyshen për shkak se demokracia vazhdon të trajtohet me mjete të anarkisë. Pse ndodhi kjo dhe si ta dekontaminojmë këtë ambient letrar?

V. ADEMI: Pa kritikë të mirëfilltë letrare, nuk ka dekontaminim të ambientit. Qarqet letrare, kanë zgjedhë që, kritikat e tyne me i adresu prej kafeve, e kulearave. Çfarë niveli të kritikës mund të presim në këtë rast.


Ndërsa sa për shtepitë botuese, mirë që nuk kemi mbetë në duer të kujdo! Mirë që kemi mundësi secili me e gjetë vendin që e meritojmë. Sa mirë që na jepet mundësia me u botu me ata që t’bajnë me u ndi i vlerësuem. Me ata që dijnë me e trajtu nji autor, që nga kontakti i parë, kontrata, promovimi, e deri te shpërndamja e librit. Prandaj libri “Katërdhetë e pak” u botue dy herë brenda ma pak se dy muajsh.

Hejza: Besojmë se Ju nuk do të pritni që vëllimin e ardhshëm poetik ta pagëzoni “Pesëdhetë e pak”?

V. ADEMI: Tashma jam këtu. Nuk kam nguti. Edhe po ndodhi kjo, mjafton të vije po kaq prashëm sikur erdhë “Katërdhetë e pak”. Ardhja ime nuk ka ndodhë për me i zanë vend dikujt, por me e pasë hapsinë që poiezia ime e do dhe e meriton.

KUSH I DËNON ME HESHTJE POETËT QË NA BËJNË NDER?

Nuk e kuptoj praninë e Ernest Koliqit, i cili nuk njihet si poet, qoftë dhe të Kasem Trebeshinës, pavarësisht se ka shkruar poezi, ata majat i kanë tjetërkund, kur harrohen poetë të mirëfilltë: si bohemë Pano Taçi, Jorgo Bllaci, Zydi Morava apo Uran Kostrecin!?



Fatbardh AMURSI

Pas antologjisë moderne shqipe të poetit Rudolf Marku "Veshun me diell mbathun me hënë", që trazoi median, botaht në Rumania një e dytë me titull "Antologia Poeziei Albaneze" (Antologjia e poezisë shqipe nga zanafilla deri më sot) në gjuhën rumune me autorë studjuesit bashkëshortë Luan Topçiu "a brilliant literary critic" dhe Renata Topçiu-Melonashi, ku po duken përshtendetjet e para. "Antologjia moderne shqipe" e autorit me banim në Londër ka të deklaruar një kriter të veçantë: atë modern, novatorë, allafranga, i cili nuk u mor parasysh si specifikë e hartimit të antologjisë. Kjo është arsyja që tek Rudolfi nuk përfshihen bejtëxhinjtë, të cilët në antologjinë e dytë janë të pranishëm. I gjithë stihia ndaj tij pati një të përbashkët: mungesën e gjithëpërfshirjes në rrafshin territorial, kryesisht mungesa e autorëve kosovarë, tetovarë, ulqinakë, etj. Duke respektuar kriterin modern të antologjisë së tij, personalisht isha për një përfshirje më të gjërë autorësh, që e plotësonin këtë kriter, kështu bëhej një mbulim më i mirë i hapësirës shqiptare, ndaj botova dhe shkrime përtë munguarin: Vehbi Skënderi, Anton Ndoci Pappleka, Niko Kacalidha, etj., të cilët i shoh të përfshirë në antologjinë e dytë, bashkë me Skënder Mehmet Buçpapajn.

Nëse unë do të hartoja një antologji nga zanafilla deri në vitet 1950, kur u instalua Realizmi Socialist, a do të funksiononte kriteri i gjithëpërfshirje duke pasur përbazë territorin? Nga Pjetër Budi deri tek Lasgush Poradeci, Fishat, Noli, Ndre Mjeda, gjithë të tjerët ishin në mërgim, si: Naimi, De Rada, Noli shto dhe Martin Camajn, Ernest Koliqin, Bilal Xhaferri më vonë, deri tek Kadare në Paris. Në këtë antologji nga zanafilla deri në vitet

50, do mungonin poetë nga trevat e tjera shqiptare, për arsyen e thjeshtë se s'ka. Përtirënenë shkurt, kriteri territorial nuk funksionon për arsy historike. Në kohën e "luftës së ftohtë", të ndarjes ideologjike të botës, të kufijve, përsëri territoret nuk ishin përbashkues. Me rënien e Murit të Berlinit, gjithpërfshirja nuk përpushtet me territoret shtetërore. (Një i huaj vesh fanellën tënde kombëtare dhe medaljet i njihen Shqipërisë.)

Antologjia e Bukureshtit pretendon se ka në fokus poezinë shqipe të shkruar në pesë shekujsh me një hartë gjeografike shumë të gjërë, duke lënë të kuptohet se janë marr parasysh të gjitha vërejtjet në adresë të antologjisë së parë, ku autorë i akuzua, po e themi më butë: përmungesë patriotizmi. Ajo që unë vërej me trishtim është se, antologjia e dytë, ka zgjeruar harten territoriale të pas viteve '90-të, duke zbruzur territore poetike të përfaqësimit, deri në "spastraime" autorësh të njohur. Për ta thënë figurativisht: përmendet Fushë-Kosova dhe zhduket nga harta poetike Fusha e Myzeqesë, e cila njihet si një trevë poetesh, si: Fasli Haliti, Izet Shehu, Gëzim Hajdari, Gazmend Kapllani, Sherif Bali, Bujar Xhaferri, Elmas Qereti, Shpend Sollaku Noe, Ilir Levonja, at e bir Radi, Lindita Arapi, Miftiadhi Davidhi, Kujtim Hajdari, Valter Dauti, etj, shto dhe poetë të Fierit: Maku Pone, Majlinda Rama, Petraq Kote, etj., qyteti që jep dhe çmimë, sikurse e mori së fundi Skënder Buçpapaj, pra, e gjithë kjo trevë s'ka asnjë poet të përfaqësuar në antologjinë e gjuhën rumune. Do më thonë se është V. Zhiti, "Qytetar Nderi" i Lushnjës, i cili poetët lushnjarë i ka quajtur "tufëzime të partisë". Të këtij mendimi me sa duket janë dhe autorët e antologjisë. Në antologjinë e R. Markut Lushnja ishte më e përfaqësuar

ar se të gjithë trevat e tjera. (Prof. Klara Kodra, mbështetësja më e flaktë e poetit Marku ndaj sulmet të kolegëve të saj akademikë, profesorë, doktorë shkencash, a do ta ndjejë mungesën e mikut të saj të vjetër në antologji, sikurse shkruan në elegjinë kushtuar atij: "Dikur t'i më qortoje/Kur vonohesha në takim./Tani e ke radhën ti/ Të vonohehet në amshim./Po unë s'do të qortoj dot/Të kërkohet në hapësirë/ Në qill, në tokë, Fasli." Ta lëmë Myzeqenë dhe të kapërcejmë oqeanin, të shohim diasporën me aktive në fushën e letrave, si ajo e Amerikës dhe e Kanadasë, aktualisht nuk i përfaqëson askush. Do më thonë përsëri: i përfaqëson V. Zhiti. Poitet i uroj suksese, por, a është normale kjo për një "kritik brillant të letërsisë", sikurse është Luan Topçiu? Në romanin "Krishti personal" Roland Gjoza shkruan: "Në Amerikë kam botuar pesë romane. Po nga atdheu mbajnë heshtje, si një lloj zie. Ne andej matanë quhemi të ikur, të harruar... Në Shqipëri kam botuar rreth 20 libra, po asnjë rresht nuk është shkruar për ta. Unë jam shkrimit i heshtjes. Kjo më ka bërë mirë, po më ka privuar nga kënaqësitet. S'më ka ecur." Në antologjinë e Rudolfit R. Gjoza ishte, tanë hiqet. Kurjoz të dija arsyen. Kush i dënon me heshtje poetët, që na bëjnë nder? Nuk njoh në diasporën e Amerikës, një tjetër të jetë më i suksesshëm nga Gjekë Martinaj, i cili ishte në antologjinë e Rudolfit, i cili është vlerësuar më shumë çmimë në ballafaqimet poetike në botë, sikurse lexojmë dhe i nominuar për Nobel. Si mund të harrohet një poete si Reshida Çobo, lërvuesja e suksesshme e haikut, e vlerësuar dhe në atdheun e Haikut në Japoni, e cila po punon për një antologji me autorë shqiptarë që lëvroatë haikun. Mund të vazhdoja dhe me emra të tjerë, por është dhe

radha e të tjerëve të flasin, qoftë duke mos rënë dakord me mua.

Të vazhdoj më tej me territorët e zbratë? Në Durrës, shto Kavajën dhe Rrogozhinën e Xhelal Toskut, përmendet vetëm Arian Leka, të cilin personalisht e çmoj, por a mund t'i hiqet viza Moikom Zegos, Petraq Ristos dhe një poet aq të pëlqyer si Agim Bajrami? (Moikomin e kujtonin se ishte akademik, të tjerë janë bërë. Edhe Rama ia kurseu fjalën e mirë, në përvjetorin e PS-ës, duke përmendur vetëm Driteron në atë përballjen e madhe për t'i ndryshuar emrin PPSH-ës. Qahen nga Plenumi IV ata që s'pësuan asgjë, ndërsa të goditurit, si Moikom Zeqo, Thanas Dino, Fasli Haliti, Viktor Qurku, etj, u takon të janë në çdo antologji dhe jo t'u hiqet viza, si të shlyejnë ndonjë amanet të demonëve të dikurshëm.) Shkojmë në Kukës. Askush. S'përmendet as Havzi Nelaj dhe as ai që harrohet gjithmonë, Agim Spahiu, që, nëse lexoni një shkrim të Luljeta Lleshanakut për të, kuptoni dhe arsyen pse e menjanojnë. "Asnjë gazetë apo revistë letrare, asnjë shtëpi botuese s'ia hapi derën, asnjë institucion ku si atëherë dhe sot profesionistë mediokër mbushnin dhe mbushin fletët e tyre. Miqtë luanin me besimin e tij." Tani luajnë vëçse me kujtimin e tij.

Nuk e kuptoj praninë e Ernest Koliqit, i cili nuk njihet si poet, qoftë dhe të Kasem Trebeshinës, pavarësisht se ka shkruar poezi, ata majat i kanë tjetërkund, kur harrohen poetë të mirëfilltë: si bohemë Pano Taçi, Jorgo Bllaci, Zydi Morava apo Uran Kostrecin? (Në Gjakovë jepet çmimi "Hamit Alija", ndërsa në antologjira nuk e plotsoka kushtin për të qenë një nga ata. Si mund të harrohet Demir Gjergji, i cili u ka recitar poezitë sa e sa kolegëve?! Po kështu Dhori Qirazi, Sadik Bejko, Sulejman Mato, Teodor Keko. Do të nderonte çdo antologji një poet lirik si Sokrat Habilaj! Nuk di pse nuk përfshihet në antologjitet poetik Nënë Tereza, poezitë e së cilës njihen në të gjithë botën? Më është krijuar përshtypja se më shumë se sa për të nderuar, tërhiqemi nga mania për të lënduar. "Njerëzit gjunjë mënyra të reja përti i shtypur të tjerët, mënyra të reja përti i zhbërë arritjet më të mira të të tjerëve."-do thoshte në këtë rast Salman Ruzhdie.

Më tërhoqi vërmendje një sqarim i Zyrës së shtypit ALAR, ku thuhej: "Si çdo lloj përpjekje e tillë në botë ka njëfarë koeficienti "subjektiviteti", parapëlgimësh për një autorë apo tjetrin." Flitet për imazhin e gabimit, duke lënë të kuptohet se mungesat apo gabimet janë të falshme. (Sipas ekspertëve, që të rrëzohet një avion duhet të ndodhin 7 gabime njerëzore të njëpasnjëshme. Mos vallë Rudolfi i kishte plotësuar të shtata? Thua se artit i kishte ndodhur një gjërmë.) Mos i merrni fjalët e mijë për kapital, por dhe "lekë xherri" apo "pare e kuqe" nuk kanë përtë qenë kurrë.

NJË NISMË E BUKUR

Anisa Mulolli, "Dornröschen, vach auf", Werlag Haus: "BoD", Hamburg

Sadik KRASNIQI

Gjimnazistja Anisa Mulolli vjen para adhuruesve të fjalës së bukur me librin e parë me poezi, dhe këtë në gjuhën e Gëtes, pra në gjermanisht. "Dornröschen wach auf", si titull libri (konvencional e përrallor) është zgjedhur me mjaft shije. Vetë titulli metaforik, "Dornröschen wach auf", (Bukuroshe e fjetur, zgjohu!), i shërben idesë, temës e poetikës së librit.

Anisa hyn bindshëm vrullshëm, e begatë, me tema e motive dhe mjaft e sofistikuar figurativisht në botën krijuar. Përmes 43 poezeve të këtij vëllimi, poetesa e re shfaq kredon e saj përmundësinë e reflektimit në mënyrë estetike të raporteve të saj me botën që e rrithon. Kjo botë është shumë e gjerë dhe e pasur me ndodhje, sende, njerëz, kafshë e fenomene. Në këtë kontekst, përpiluesi i parathënisë së librit, njëherësh arsimtar i poetes, Frank Hegemann, shprehet: "E gjithë bota në një poezi" (In einem Gedicht die ganze Welt).

Poezitë e Anisës janë frysme të perceptimit të një adoleshenteje përbotën që e rrithen.

Këto marrëdhënie të determinuara nga mosha e saj delikate janë tejet emocionale, por njëherazi intelektuale dhe, gjithsesi, edhe estetike. Poezitë e saj, përvëç aspektit estetik, kanë edhe atë etik: merr sa të duhet, jep sa duhet - shprehet Anisa në një poezi.

Vetë titujt e poezeve janë shumë impresive, si: Përmes qytetit, Teatri në teatrë, Ata janë vetëm gënjeshtarë, Nata, Nga se njerëzit janë të tillë, Bota, Nëse njerëzit qajnë, Gjenerata e re, Fund i gjëzuar, Sensi, Zemra, Pritja e trenit të fundit, Ndjesë, Vetë mbretëreshë, Bukuroshe e fjetur, zgjohu! Gjethi në e, Gjithmonë fëmijë, Dashuri ose para, Lexoni çfarë shkruaj, Më mbaj, Kukullat e bukura, Rrottarja e natyrës, Gjarpri, Psikopat shëruar, Klithja, Humbësi, Nuk do të harroj, Heshtje para rrufesë, Shtegu im, Të gjithë e dimë, Zëri i sirenës etj.

Poezitë e këtij libri janë ligjërimë lirike të një introspektive të thellë të poetes në



marrëdhënie me jetën, shoqërinë, rrethanat, sendet, gjërat dhe fenomenet e përditshmërisë.

Ajo, duke parë e përfjetuar realitetin e jetës si "matematikë tejet të vështirë" (Die Realität ist die schwertse Matematik), me kompleksitetin e vështirësitë e saj të shkaktuar nga të rriturit, herë-herë bie në situata të personazhit Oskar, të Gynter Grasit, me dëshirën që të mbetet gjithmonë fëmijë, si sinonim i pafajësisë, ciltërsisë dhe engjëllorës.

Duke lexuar disa poezi të Anisës, sikur hasim në një "zyrtësi", por kjo "zyrtësi" nuk ka të bëjë fare me pesimizmin, është

thjesht një revoltë përgjërat që nuk i pëlqejnë poetes, ose siç thotë Niçja, "pesimisti është një idealist i zemëruar". Ndaj poetesa ka shpresë, vizion, ideal për një të ardhme më të mirë, përtë cilën lufton si gjeneratë me zemrën e mirë dhe rrëndjen e ndritur. Poetesha në një poezi shprehet: "Wenn Menschen weinen, strahlen ihre Herzen" (Nëse njerëzit qajnë, zemrat e tyre shkëlqejnë).

Semanika e ligjëratës poetike te ky vëllim me poezi ndërtohet përmes një struktore sintaksore me vargje të gjata në strofë monokolonëshe. Vargjet janë fjali të zgjeruara me të gjitha pjesët e

ligjëratës, me një arsenal të pasur leksikor. Duke qenë se në këto poezi ka shumë detaje, poeteshës sikur i imponon het forma e të shprehurit me një strukturë "prozaike". Por, në esencë, kurrsesi nuk është e tillë, nga se vargjet kanë një ritëm metrik me një harmoni të bukur intonacioni, përmes rimave të bukura fundore. Vargjet me rima e bukura dhen përhershme imponojnë një lexim deklamativ me një emocion përfjetues e impresiv.

Figurshmëria në poetikën e Anisa Mulollit është një estetikë e kontrasteve metaforike e metonimike: "Nur noch Sterne, die fungeln (shkëlqejnë)

Und überleben können im dunkeln" (errësirë)

Në fund mund të themi, se niveli i lartë artistik i librit të parë me poezi i Anisës jep sinjalët e një talenteve me një personalitet të fortë që në të ardhmen e afërt do jetë një krijuar e shquar dhe me shumë botime. Këtë, madje, e thotë edhe vetë poetesa përmes vargjeve me plot kredo: "Natürlich bin ich stark, klar mache ich weiter", (Natyrisht jam e fortë, qartë, e unë do të vazhdoj tutje)

Anisa Mulolli është 17 vjeçë, lindur dhe rritur në Hagen të NRW të Gjermanisë, me rrënje shqiptare. Që e vogël gjithmonë ka qenë në skenë, qoftë në shfaqje teatrale apo si recituese e poezeve të poetëve shqiptarë në Gjermani. Ajo ka qenë gjithmonë e interesuar për artin e poezi të dashur t'i shprehë mendimet e saj përmes këtij arti.

Anisa Mulolli është nxënëse e gjimnazit "Ricarda-Huch-Gymnasiums", në Hagen. E frysmezuar nga mosha e saj prej adoleshenteje, ajo filloj të hartonte libër, që do të ishte i kuptueshëm për shumëkënd. Qëllimi i saj kryesor ishte të shkruante një libër, që pasqyron mendimet dhe ndjenjat e shumicës së të rinjve, por edhe të krijonte diçka që e motivon lexuesin të ecë përpara dhe të jetë i lumtur në jetë.

Oasje

KONCEPTI I TEATRIT PËRRALLOR

(Rreth novelës "Kërrici i pikëlluar" të shkrimitarit Abdyl Bunjaku)

Xhahid BUSHATI

Abdyl Bunjaku, shkrimitari nga fshati Novoselë i Vushtrrisë (Kosovë) u nda nga jeta 31 vjet më parë, në moshën 88-vjeçare. Në krijimtarinë e tij artistike shquhet përlëvizimi i novelës, pjesëve teatrore e skecave. Mbështetet e pakët të letërsisë shqipe përfëmijë, që struktura e novelistikës së tij të jetë e zhvilluar në formën e një skene teatrore, ku personazhet dialogojnë, replikojnë, kundërshtojnë një-tjetrin, ndodhen para të papriturave, janë në rrezik e vështirësi... etj., etj. Një model të tillë përfaqësimi i realizimi i gjëjmë te novelë "Kërrici i pikëlluar" ("Rilindja", Prishtinë 1977; Sh. B. "Naim Frashëri", Tiranë 1983, redaktor: Kostandin Leli).

Është një novelë përrallë me zhvillim linear, ku gjatë udhëtimit të Kërricit, herëpasHERE gjëjmë përthyerje

ngjarjesh e historish, të papritura, gjë që i jepin novelës frysme, e bëjnë më interesante dhe kurioziteti i fëmijëve shtohet nga faqja në faqe, me pyetjet: "Ç'po ndodh me Kërricin? A do të mbetet ai i pikëlluar? A do të kthehet, përsëri te Oborri i Madh? A do të gjëzojë zemrën e babait të tij, Gomarit Zemërbutë? A do të gjëzojë shokët që e presin me mall?" ... etj.

Novela është ndarë në 14 kapituj. Historia fillon me një letër, e shkruar në mënyrë mitike e paksa legjendare nga Kërrici, ku tregon arsyen përsë po ikën... Ai mendon se i ati do ta lexojë letrën, por fatkeqësish së bashku me sanën Delja Gjumashe ha dhe letrën. Me këtë enigmë nisin ngjarjet. Skena është Oborri i madh, ku kafshët e shpendët si Pula e Kuqe, Rosaku i Madh, Delja Gjumashe, Gjel Kamkaceli, etj. filozofojnë, hamendësojnë, thurin fjälë shpesh të paqena rrëth ikjes së Kërricit. Nga dialogu i tyre tensioni përrallohet merr

përmasa jo të zakonta që shoqërohet me shumë pikëpyetje. Pra, letra është "e panjohura", dhe me këtë të panjohur nis elementi i parë i ndërtimit kompozicionali i veprës.

Gjatë udhëtimit të Kërricit të Pikëlluar, kemi edhe një zgjerim të mëtejshëm të subjektit të novelës. Disa personazheve si: Shqiponja (i kërkohet të gjëjet Kërricin), një lopë me historinë e saj i bëhet model Kërric, ndërsa hutini e paralajmëron përrrezikun që i kanosej, kurse Drenusha është qortuese ndaj personazhit kryesor, dhelpra është mashtruese, Ujkona plakë përpak sa nuk e ha, lepuri e ndihmon,... Dhe ky udhëtimi prej përralle fillon me Oborrin e Madh dhe përfundon me Oborrin e Madh. Dhe Kërrici, nga i pikëlluar bëhet i qeshur, kur dëgjon zërin e babait, kur i thotë: "- Djali im, shpirti im... shëndoshë qenke! - dhe lotët i dolën nga gjëzimi. I lëpinte fytyrën, veshët, trupin...". Me

kthimin e Kërricit, përsëri, te Oborri i Madh, autori me shumë finesë e pa moralizim nënvizon mesazhin e madh: Vendlindja është e shtrenjtë! Ajo nuk duhet harruar dhe nuk duhet iku e braktisur!"

Brenda hapësirës së kësaj novele të bukur e tërheqëse, krahas emërtimëve përrallore të kafshëve e shpendëve, gjetjeve të bukura e kuptimplotë; shfaqet plot ngjyra bota e tyre, individu-alizohen estetikisht ato, përshtkuhen mëdise me koloritin e tyre përkates, etj. Gjuha e përdorur nga autori Bunjaku është në përputhje me botën fëminore, është e gjallë dhe poetike. Autori e njeh shumë mirë gjininë e përrallës, veçanërisht përrallën popullore, çelësat e saj të shkrimitarës. Kërrhëria mbetet një nga dukuritë dalluese të novelës, gjë që e bën të lexohet edhe pas kaq vitesh me tëndje nga lexuesit e vegjël. Një vepër që nuk e humb aktualitetin.

Jeta si tregim

MAGJIA E PALIGJËSISË SË SUKSESIT

Në vëllimin tim të fundit "Transaksi" vendosa të nxjerr tregimin Ura, një tregim që e kam mbajtur 30 vjet në dorë. Megjithëse për atë libër u shkrua jo pak, atë tregim nuk e përmendi kush

Dashnor KOKONOZI

Në të vërtetë nuk ka nevojë të shkruash letërsi për ta kuptuar se suksesi nuk ka asnjë ligjësi. U ka ndodhur të gjithëve të kalojnë orë, duke gatuar me shumë përkujdesje një post për fb-në, ta kthejnë e rrullojnë nga të tëra anët, ta trazojnë dhe t'i shtronjë ca erza e citime, ta lënë të ftohet, ta shkojnë edhe një herë dhe ta postojnë. E së fundi të mbeten të zhgënjer: askush nuk tregon interes përf t'ë!

E pastaj, një herë tjetër, t'i hedh shpejt e shpejt nga dy shënimë ashtu si i kape duke të kaluar nëpër rrjetin e neuroneve të kokës tënde dhe vëren gojëhapur se si vërhojnë komentet përf t'ë.

Si ndodh? Kam përshtypjen se suksesi varet vetëm pjesërisht nga autor, por nuk di më shumë. Ajo që dua të them është se këshfu ndodh edhe në letërsi, të paktën në përvojën time modeste. Se në fund të fundit, edhe letërsia (fikcion) një lloj komunikimi si të tjerët është. (Vetëm lista e pazareve të ditës bëhet përf t'u hedhur, ka thënë ai)

Në vëllimin tim të fundit "Transaksi" vendosa të nxjerr tregimin Ura, një tregim që e kam mbajtur 30 vjet në dorë. Megjithëse për atë libër u shkrua jo pak, atë tregim nuk e përmendi kush. Nuk dua të ngjall kurestje komerciale dhe do të tregoj me dy fjalë subjektin e tij.

Është një ngjarje e jetuar që ka ndodhur gjatë një loje ushtarake me ermin Biza më duket. Që në fillim fare kompania jonë humbi qd kontak me shtabin, ecnim të uritur e të rraskapitur nëpër borë e shi pa e ditur se ku shkonim, deri sa një mesnatë, nga radioja na erdhë urdhri të kalonim një lumë të rrëmbyper që kishin përparrë. Përtej, do të prisnim urdhrin përf sulm. Mbi supe kishim grykat e topave dhe arkat e municionit dhe komandant (oficer rezervë) i asaj kompanie antitankesh ishu unë (dk).

U nisëm me shpirtin nën dhëmbë dhe së fundi mbërritën në breg të një lumi të egërswar

nga shirat, që as emrin nuk ia dinim. Askush nuk na kishin treguar sa i thellë ishte. U futën duke ndjerë gurët që rrëshqisnin nën këmbë dhe trungjet e pemëve të thyera nga stuhia që zbrisin me vrell nga malit...

Një tmerr i vërtetë. Po nuk kishim rrugë tjetër. U futën të gjithë duke mbajtur njeri-tjetrin, por me gjithë përpjekjet, matanë nuk dolën të gjithë. Në atë lojë ushtarak u vrancë gjashtë vëtë, kuformë e ndonjërit u gjet vonë, në pranverën e ardhsime. Unë munda të dal gjysmë i vdekur. Rryma më kishte hedhur e mbuluar me baltë e llucë në breg.

Kur zbardhi, munda të hap sytë. Për çudi, tutje njegullës, mbas revë të ulëta, pasqë një urë druri mbi lumë, që nata nuk na kishte lejuar ta shohim. As njëqind metra largi Kërkush nuk na kishte thënë gjë përf t'ë. Kishim bërrë sakrificë të tmerrshme, kishim vuajtur një të ftohtë qeni, kishim parë vdekjen me sy e madje kishim vdekur pa e ditur se zgjidhja kishte qenë m'u aty më vonë, edhe pse fajt ishte i të tjerrëve.

E shihja dhe e ndjeja se ai tregim më thoshte diçka, por nuk e kuptoja se çfarë. Të paktën jo menjëherë. Dora-dorës, duke u kthjelluar edhe vetë kuptova se ishte një metaforë e dhimbshme e historisë moderne së Shqipërisë. E sakrificeave dhe mundimeve të kota të një populli të tërë që u tërhoq zvarrë nga një ideologji vrastare dhe po aq e panevojshme.

Kuptova edhe se ai ishte tregimi i jetës sime dhe së fundi vendosa ta botoj te vëllimi Transaksi (2022). U thanë fjalët më të mira për shumë nga tregimet e tij, as një fjalë përf t'ë. Ai nuk i ra në sy askut! Kisha ndeshur në murin e magjishëm të pamatarueshmërisë së suksesit. Gjë që në vetvete, po ta shohësh nga afër, është diçka e rrëmbejshme!

Dashnor Kokonozi Transaksi

Tregime
UEGEN®
NETIMI I LARTIT DOLLA I KURAT



Portrete

TERESA WILMS MONTT

Shkrimitarja e re Teresa Wilms, edhe pse një pjesë të mirë të jetës e kaloi larg vendlindjes, ajo u bë një mit dhe një idhull i vërtetë përbashkatdhetarët e saj. Edhe kur ishte e mbyllur në manastir, ajo u kthyte në legjendë në Kili

Bajram KARABOLLI

Teresa Wilms Montt lindi në Vinja del Mar (Kili) në 1893. E bija e një familjeje të elitisë tregtarë dhe politike kiliiane. Idetë e saj feministe dhe anarkiste, bënë që ajo, e nxitur nga shqetësimet të brendshme, qysh herët, të fillojë të botojë tekste poetike. E aftë përf t'i përvetësuar me lehtësi gjuhët e huaja, mësoi frëngjisht (në këtë gjuhë e shkroi edhe ditarin e saj), anglisht, italisht, portugalisht dhe pak gjermanisht. Teresa, në moshën shtatëmbëdhjetë vjeçare, u martua me Gustavo Balmaceda Valdés. Kjo lidhje e lejoi atë të jetonte në vende të ndryshme të Kilit. Me të pati dy vajza, por alkooli dhe xhelozia e të shoqit shkaktuan konflikte të ashpra familjare. I shoqi, pasi e akuzon përf një pabesi të supozuar me kushërin e tij, Vicente Balmaceda, e mbylli me forcë në Manastirin e Gjakut të Çmuar të Santiago. Aty shkroi një pjesë të konsiderueshme të ditarëve të saj.

Pas një kalimi të shkurtër nëpër Shtetet e Bashkuara, ajo shkon në Spanjë, ku i fërkua me intelektualët e kohës - shumica e të cilëve ranë në dashuri me këtë vajzë me sy të mëdhenj dhe pasion të lirë. Aty nga mesi i udhëtimeve të vazhdueshme nëpër Europë, ajo ribashkohet me dy vajzat e saj në Paris.

Në qershor të vitit 1916, bashkë me poetin e njohur kilian, Vicente Huidobro, shkojnë në Argentinë dhe qëndrojnë në Buenos Aires. Falë qëndrimit të saj në këtë qytet të madh, shquhet përf intelektualitetin e saj kozmopolit dhe krijon miqësi me shkrimitarët e mëdhenj

argentinas: Viktoria Okampo, Jorge Luis Borges, Pelegrina Pastorino, etj., një rrymë kjo që pati ndikim të madh tek Teresa. Pojetja Teresa Montt, përf shkak të dhimbjeve të padurueshme të kokës, konsumonte droga opiumi. Ky qe edhe shkaku kryesor që ajo kishte tentuar disa herë t'i jepte fund jetës. Dhe këtë e bëri në vitin 1921, kur ndodhej në Paris. Kësisoj, kjo shkrimitare përfundon tragjikisht, nga një dozë e rëndë opiumi, duke ikur nga kjo botë, pasi jetoi vetëm 28 vjet.

Gjatë një periudhë tre vjeçare në kryeqytetin argentinas, Teresa Montt bota të gjithë librat e saj, duke u bërë e njohur në qarret intelektuale spanjolle.

Shkrimitarja e re Teresa Wilms, edhe pse një pjesë të mirë të jetës e kaloi larg vendlindjes, ajo u bë një mit dhe një idhull i vërtetë përbashkatdhetarët e saj. Edhe kur ishte e mbyllur në manastir, ajo u kthyte në legjendë në Kili. Në krijimtarinë artistike kishte zgjedhur pseudonimin THÉRÈSE DE LA CRUZ. Ja, ç' thotë përf t'ë, miku i saj i fëmijërisë, poeti Vicente Huidobro: «Teresa Wilms është gruaja më e madhe që ka prodhuar Amerika. Fytyrë e përsosur, trup i përsosur, elegancë e përsosur, edukim i përsosur, inteligencë e përsosur, forcë shpirtëre e përsosur, hir i përsosur.» Ndërsa ajo vjetë, në ditarin e saj, i thotë kështu lexuesit: «Unë jam Teresa Wilms Montt dhe, megjithëse kam lindur njëqind vjet para teje, jeta ime nuk ka qenë shumë e ndryshme nga jeta jote».

Veprat e saj janë: "Shqetësimet sentimentale" (Buenos Aires, 1917), "Tri këngët"

(Buenos Aires, 1917), "Në qetësinë e mermnerit" (Madrid, 1918), "Anuari" (Madrid, 1918) dhe "Tregime përf burrat që janë ende fëmijë" (Buenos Aires, 1919). Pas vdekjes, shtëpia botuese Nascimento bota në Kili "Çfarë nuk është thënë" (1922), ku ndër të tjera përfshihen edhe një pjesë e ditarëve të saj. Në vitin 1993, Ruth González Vergara publikoi një biografi të gjerë dhe të dokumentuar të saj, të titulluar "Teresa Wilms Montt: një këngë përlirinë".

TERESA WILMS MONTT
BIE SHI...

Pikat e shiuat këndojnë në ulluqet prej zinku.

Drita e llambës më është bërë më intime; portretet më shikojnë plot besim dhe gërrhitja

e maces vjen shtruar, me butësinë e një violine.

Zemra ime pret. E kam mashtruar, duke bërë

të besojë se sonte do të vijë një genie e dashur.

Dhe e mjera zemër, me shpresë të madhe, pret!

A thua jeta nuk qenka një shpresë e amshuar,

një pritje e përfjetshme përf diçka që nuk vjen kurrë...

Bie shi...

(Përktheu: B Karaboli)



POETI QË I DHA HAIKUT NGJYRA SHQIPTARE

Duke lexuar librat e tij të shumtë me poezi dhe haiku, të bën përvete me temat e zgjedhura dhe plot zëra jete nga realiteti, por edhe stil i shkathët dhe elegant. Novi fuste veten në çdo varg dhe diinte të identifikohej me të. Ai shkruante kur i shkruhej dhe jo se duhet t'i shkruante

Agim BAJRAMI

Atë mëngjes të trishtë dhe përzhitës korriku (jo si ky i sivjetmi, që i ka kaluar 44 gradët) ecja mbi rrugët gjysmë të zbrazura të Elbasanit, shqëruar nga një dhimbje e vazhdueshme dhe gërvishëse koke. Qyteti ende vazhdonte të përpëlqej mbi zgarën e nxehëtë të verës dhe afërmendsh që diçka nga temperatura e tip po ma kalonte edhe mua, por unë isha i bindur se këtë radhë nuk mund të ishte vetëm ky shkaku. Atë ditë porsa ishte ndarë nga jeta një nga emrat më të njohur dhe dalluar të poezisë sonë bashkëkohore, poeti Milianov Kallupi, i njohur në botën e letrave edhe si poeti i haikut. Ngrita kokën nga qilli dhe m'u duk se e pashë këtë njoftim shkruar edhe nga tufat e reve të thara, që i kishin shpëtuar egërsisë së diellit dhe kishin dalë atë ditë enkas për ta përcjellë atë në banesën e fundit. Atë qast edhe përpës idësë se po përfetoja një halucinacion, i dhashë pak të drejtë vetes se në momente të tillë, dhimbja mund të nxisë brenda teje gjithfarë lloj fantazish absurde. Dhe, aq më tepër, kur bëhej fjälë për Milianov Kallupin, njeriu që lindi dhe u rrit bashkë me vargun lirik dhe nuk u nda prej tij gjer në vdekje, atij që ngazellehej dhe merre dritë edhe nga qiejt pa shkëqim të dimrit, njëllor si nga hëna e shenjtëruar me brorerë prilli, drejtuesin për një kohë të gjatë të klubit të shkrimitarëve dhe poetëve të Elbasanit autorin e dhjetëra librave të suksesshëm me poezi, poetin, stilin e të cilët kritika janë letrare e ka karakterizuar si një ndërthurje të suksesshme të tradicionales, modernes dhe postmodernes dhe, për më tepër, njeriu që eksperimentoi dhe promovo me sukses një nga gjinitë letrare më pak të njohura gjer në atë kohë në Shqipëri, haikun japonez, presidentin e Klubit të haikut shqiptar, me seli në Elbasan, poetin e dhjetëra librave me vlerë, me poezi lirike dhe me motive ushtarake, botuesin e pasionuar të Shtëpisë botuese "Egnatia", njeriu që i bindte me lezet pushtarët lokalë, të vinin duart në xhep



herë pas here, për organizimin me sukses të festivaleve dhe orëve poetike të panumërtë, herë nën pishat madhështore të Gjinarin dhe herë të tjera buzë ligeneve magjikë të Belsnit dhe Dragotit, ai që i mblidhët nga çdo kënd ku flitej dhe mendohet shqip, poetët më të mirë dhe punëtorë të palodhur të fjälës poetike, një nga mohikanët e paktë të viteve të rrëmuishëm të tranzisionit që mbajti të bashkuar aradhën e madhe të shkrimitarëve dhe poetëve. Ndonfta më shumë se për të gjitha kontributet e dhëna, Milianovi meriton të nderohet për këtë të fundit. Jo më kot portretin e tij shpirtëror dhe poetik një jetë poet po nga Elbasani, Fatmir Terziu, do ta karakterizonte me dyvargësin e godit:

Në qytetin pa shpirt
Ai i hodhi një zemër
Sa herë vjen dita e verës në Elbasan,

krahas gazmendit të festës dhe risjelljes identike të riteve me karakter pagan, që i përkasin vetëm këtij qyteti, më vjen në mend edhe ftytyra e qeshur dhe energjike e poetit, mbështjellë me ritmin dhe finesën e poeziave që mbushin skenën e Teatrit Skampa gjor vonë në mbrëmje. Nosi, siç i flisin miqtë me përkëndelje ose Milianov Kallupi, diti ta qdhendë emrin e tij jo vetëm në këto lloj aktivitetesh, por në gjithçka tjetër që lidhej me letërsinë dhe kulturën. I tillë, energjik dhe i palodhur u tregua ai edhe gjatë riorganizimit të Lidhjes së Shkrimitarëve të Shqipërisë, në mbrojtjen e godinës së Lidhjes nga kthethrat e pushtatarëve, që bënë gjithçka për ta rrëmbyer dhe transformuar, përmiratimin e një statusi të veçantë për shkrimitarët dhe artistët e pambrojtur të vendit të tij, duke pritur mbi vete kësishoj edhe reagimin e egër

të tyre. Duke lexuar librat e tij të shumtë me poezi dhe haiku, të bën përvete me temat e zgjedhura dhe plot zëra jete nga realiteti, por edhe stil i shkathët dhe elegant. Novi fuste veten në çdo varg dhe diinte të identifikohej me të. Ai shkruante kur i shkruhej dhe jo se duhet t'i shkruante. Këtë përvojë u mundua t'ua përcillte sa të mund poetëve më të rinj që e rrethonin dhe nuk i ndaheshin asnjëherë. Karakteri i tij ekspresiv, e ktheu atë në një misionar idealist të poezisë, një promovues të palodhur të saj. Sa herë që dégoja për zhvillimin e ndonjë aktiviteti letrar në Elbasan, Librazhd, Gramsh e Cërrik, nuk ishte e nevojshme të pyesje përmirësimi i tij.

Milianov Kallupin në Elbasan e njihnin dhe e nderonin edhe drurët edhe gurët, më thoshta atë ditë duke ju dridhur buza, mikulli shoku i tij, poeti i njohur Zyhdhi Morava. Ndonfta ky ishte shkaku që konfiguracioni i atyre pak reve që qëndronin mbi qill më ngjau si njoftim qellor, kjo eshtë arsyja që edhe përkundrejt asaj vase torturuese, pranë arkivolit të tij kishte kaq shumë supe dhe duar që e mbani që nga Besnik Lena i Strugës, Nuri Plaku i Fierit, Fatmir Minguli i Durrësit, Beatrice Balluci, Kujtim Agalliu, Alfred Molloholli, Fatmir Musai, Vehap Xhindole Mihal Disha etj. I lodhur nga toka, ai po njitej drejt qillit për t'iu dhënë vargjeve të tij një ngjyrë më të kaltër. Ja pse, ndonëse kanë kaluar kaq vjet nga ajo ditë e trishtë ikje, mua më duket se tufat e atyre reve vazhdojnë të janë ende aty. Pa lëvizur fare.

Shqyrtimë

ENIGMË E PAZBULUAR SHPIRTËRORE

(Rreth poezisë "Kroi i fshatit tonë" të Lasgush Poradecit)

Sulejman MEHAZI

Arti poetik i Lasgush Poradecit në plotëkuptimin e fjali të shpirtërore, dallimi i enigmës së prozës kadareiane të enigmës shoqërore, kurse kuptimi i poezisë lasgushiane të enigmës shpirtërore (Vallja e Yjeve, Ylli i Zemrës), Pra, poeziët e shpirtërore, kurse proza e shpirtërore, Lasgush Poradeci është i pakrahueshëm sipas enigmave të fshehta(mistikë) poetike. Me anë të enigmave Lasgushi krijon e formon figura të jashtëzakonshme stilistike, metaforike e gjuhësore. Si shembull e marrim poezinë: "Kroi i fshatit tonë", në të cilën Lasgushi shpreh enigmë të dyanshme:

"Kroi i fshatit tone, ujë i kulluar,
ç'na buron nga mali, duke mërmëruar"

dhe të asaj të përjashtmes pikture-ske e teknike-stilistike:

"Venë e mbushin ujë vashat anembanë"

cipëzën me hoja lidhur mënjanë;"

Prandaj vlera e poezisë së Lasgushit është e veçantë dhe e pakrahueshme për shkak enigmave poetike, ai se tregon as enigmën e brendshme poetike të kroit, as enigmën e jashtme piktoreske të kroit e vashave nuk e tregon. Sikurse të kishte shfaqur enigmat poetike, atëherë poezië e tij do ta humbte vlerën e saj të jashtëzakonshme.

Lasgush Poradeci me "Kroi i fshatit tonë" bëhet kultivues i kopshteve imaginatyive-mistikë-shpirtërore, sikurse kopshtarët që kultivojnë lulet me lloje ngjyrash, shijesh e aromash, po ashtu dhe poeti në këto forma, mënyrash e motivesh, ka kultivuar poetikisht kroin e fshatit të tij.

Lasgush Poradecit në "Kroi i fshatit tonë" është:

- kultivues i ndjenjave poetike:
"E si mbushin ujë, bubu ç'm'u ka hije,
ndaj kthehen prap me hap nusërije
ndeuzur yll i ballit si yll shenjtërie,"

apo:

"Vashëzën bujare që po vin në krua
Siç përshëndeta, siç'm'u turpërua
Papu ula kryet e shikova si grua";

"Derdhet aq i egër, derdhet aq i qetë,
posi malli i vashës, që djeg në të
fshehtë,

posi malli i trimit, që buçet përjetë,
obobo, si malli, që nuk vdes përjetë."

- kultivues i pamjeve figurative:

"Venë e mbushin ujë vashat anembanë

cipëzën me hoja lidhur mënjanë;

Cipëzën e bardhë, cipëzën e kuqe,
gushën si zëmbaku, buzët si
burbuqe.",

apo:

"Kroi i fshatit tonë, ngjyr' ergjënd i
lyer

që nga rrëz' e malit ç'na buron rrëmbyer.

Venë e pinë ujë trimat anembanë
takijen me lule, përmbi sy mënjanë.

Takijen e dli, takijen e nxirë
Buzën në të qeshur... më të
pshëritirë..."

- kultivues i ngjyrave poetike:

"Cipëzën e bardhë, cipëzën e kuqe,
gushën si zëmbaku, buzët si
burbuqe",

apo:

"Takijen e dli, takijen e nxirë
Buzën në të qeshur... më të
pshëritirë..."

- kultivues i muzikaliteteve e
ritmeve shpirtërore:

"Kroi i fishatit tonë, tetë sylynjare
në të krahina qënke kroi i parë
qënke një në botë, s'paskërkë të dytë
ç'na shëroke plagët, ç'na shëroke
sytë.

Kroi i fishatit tonë, n'atë mal me
fletë,

derdhet aq i egër, derdhet aq i qetë
posi malli i zemrës mu në gji të
shkretë."

VETMIA POZITIVE NDËRMJET PËRSOSJES INDIVIDUALE DHE ORGANIZIMIT SHOQËROR

Qeniet në gjithësi nuk janë vetëm një grumbull i gjërave pa identitet dhe esencë, ata në "fytyrën e vërtetë" të tyre, pra subjektive, e kanë veten e tyre. Ata janë identitete individuale dhe e shfrytëzojnë identitetin e tyre për ta kompletuar funksionin e dukshëm ngjashëm siç inxhinieri i shfrytëzon pjesët e ndryshme për ta kompletuar kompjuterin



Nga Metin IZETI

Çdo herë kur provoj të shkruaj diçka në lidhje me mënyrën e të menduarit dhe ngjarjet e hapësirës dhe kohës ku jemi duke e harxhuar fryshtë, e përjetoj një shtërgim dhe ngushtim të brendshëm. Disa herë përpiqem që ta kuptoj këtë shtërgim si paftësi ose pamundësi e shprehjes së krejt asaj që e ndiej në lidhje me mendimin dhe ngjarjet, por arma disa herë jam shumë i bindur që ky shtërgim është rrjedhojë e pamundësisë së artikulimit të kuptueshëm të asaj që e përjetojmë ne si realitet dhe vetë realitetit original. Bota e ngjarjeve edhe në kontekst të sqarimit të tyre është e kufizuar rreptësish në lëndoren, por edhe më e rrezikshmja është se edhe mendimet që u paraprinë ngjarjeve dhe që pasojnë si analizë sistematike e tyre janë të robëruara nga hapësira shqisore. Kjo ma zgjeron pak kraharorin pasi jam i bindur që mendimi dhe ideja nuk mund të ndjekë ngjarjen, ai është kandidati kryesor për ta krijuar atë, ngjarja paraqitet si rrjedhojë e zbatimit dhe implementimit të plotë ose të mëngut të mendimit ose në skajshmërinë tjetër, si rrjedhojë e mosimplementimit të mendimit. Ta them të drejtën më pengon shumë skllavërimi i skajshëm i qenies më të përkryer të dalë në hapësirën fizike, pra, njeriut (kjo e vërtetë e pranuar nga të gjithë, janë teistë, ateistë,

agnostikë) për kufijtë e syrit, të veshit, lëkurës, hundës dhe gjuhës! Kjo kështu pasi pa shumë analizë e shoh që secili prej nesh, që nga fëmijëria e deri në pjekurinë më të madhe, mendon për gjëra që nuk janë në kufijtë e të sipërpërmendurave. Bile edhe ata që skajshmërisht udhëhiqen nga kufijtë lëndorë nuk mund të jetojnë pa menduar përgjëra që në kornizat e kohës dhe hapësirës ku jetojnë janë të pakapshme.

Kureshtjen për ta kuptuar drejtë se mos vallë jam jashtë realitetit të kohës dhe hapësirës ma shton edhe fakti se të gjithë përreth meje dhe më gjerë shumë më tepër joshen nga gjérat që nuk janë lëndore se sa ata lëndore, por arma, leri ato që botën e kuptojnë si lëndore, edhe fetarët, èndërrimtarët, surrealistët, futuristët, sihirbazët paraqiten me një dëshirë të flaktë që ta materializojnë dhe ta prekin fenë, èndrrën, imagjinatën, ankthin, shtërgimin e brendshëm. A mos vallë është e vërtetë teoria për shmagjepsjen e botës dhe njeriut!

Që të jem më i qartë, nuk mund ta kuptoj si njeriu i skajshëm në lëndoren e parapëlqen artin abstrakt ose ekspresionin në vend të realizmit ose vizatimit teknik; si juritë me nam të botës së filmit e parapëlqejnë filmin pa zë në vend të atij ku dëgjohet biseda; si grafikët janë më të ekzaltuar nga portreti i deformuar/imagjinari dhe jo nga ai

real; nuk i kuptoj edhe fetarët dhe folësit përfenë që më tepër kënaqen kur e dëgjojnë lexmin e bukur të Kur'anit se sa nga bisedat juridike apo apologjetike në lidhje me të vërtetat fetare. Shpesh e pyes veten a mos ky koncept i sjelljes tonë është paradoks!?

Ose edhe në çështjen e mendimit dhe ndjenjës kemi vendosur që t'i imponojmë vetes sjelljen dyfyrës, të mendojmë dhe ndiemjë ndryshe dhe të shprehemi ndryshe, duke qenë të bindur, me një egocentrizëm dhe narcizëm demonik, se të tjerët nuk janë të përgatitur ta kuptojnë dhe ta jetojnë të vërtetën tonë ashtu si e dimë ne dhe pikërisht për këtë, ata duhet ne t'i përgatitim me dekada dhe shekuq që ta kuptojnë, ndërsa në ndërkokë ne do t'i shijojmë të mirat dhe leverditë e të qenët padronë të tyre? Mendoj që ky është realiteti në prapavijen e tërheqjes së kufijve me vizore dhe ndarjes së familjeve, kombeve, gjaqeve, pasi ata ende nuk janë të përgatitur ta kuptojnë realitetin si ne dhe si rrjedhojë duhet t'i përgatitim për këtë!

Antropologjia na mëson se njerëzit mendojnë në bazë të shprehive të tyre. Kjo kështu për shkak se nuk kanë dëshirë shumë të zgjerohen dhe shtrihen dhe pasi kanë frikë nga ndryshimi. Ky ka qenë edhe shkaku kryesor i konfrontimit të pejgamberëve me popujt e tyre, por edhe shkaku i dënimit të Sokratit,

ekzekutimit të shumë shkencëtarëve në mesjetë, ndërsa ne i kemi fajësuar pandërprerë ata që kanë qenë kundëri avangardizmit dhe kërcimit andej gardhit. Bisedat tonë më të shpeshta janë përplot me akuzë ndaj konservatorizmit dhe pengimit të mendimit ndryshe. Po mirë, kjo vlen vetëm për rastet kur duhet të sulmohet ajo që ne kemi dëshirë ta imponojmë si mendësi që nuk e përjetojmë edhe vëtë, me fjalë të tjera, si dyfyrësi ndaj vetes, ose vlen si parim i përgjithshëm? Nuk ka dyshim se çdo njeri pak i logjikshëm do të pajtohej se është parim i përgjithshëm. Atëherë, çka është avangarda e mendimit të njeriut që jeton sot, do t'i themi këtij, modernizëm, postmodernizëm, ose postpost modernizëm? A mos njeriu e ka skllavëruar vet veten e tij dhe sillet në trajtë inkvizicionale ndaj çdo gjëje që do t'ia kishte prekur, bile edhe pak, dyfyrësinë e sjelljes në brendi dhe jashtë? Unë mendoj se, po.

Ta bëj edhe një digresion, ndoshta për ta derdhur shpirtin tim edhe pak më qartë në lidhje me këtë çështje. Njeriu i sotshëm kur bëhet fjalë përdukjen e jashtme nuk ngurron që të kthehet në të kaluarën dhe ti rikthejë në modë gjérat që kanë qenë atraktive para dyzet viteve. Kolekcionisti Cruise edhe në vitin 2018, si edhe vitin e kaluar, i ka parapëlqyer mantelet e gjatë e të gjashtëdhjetave dhe pantallonat e gjera; Louis Vuit-

ton, Marni dhe Prada, në pothuaj të gjitha trendet e tyre të fundit, kanë prezantuar pantallonat e gjera, një veshje vintage dhe mjaft elegante që krijon freski gjatë sezonit të verës. Ata në reklamimin e tyre thonë: "...në rast se akoma nuk e keni marrë vesh, vitet '70 janë rikthyer. Dhe fuqishëm madje...". Si rrjedhojë, gjatë sezoneve të fundit, shumë nga emrat më në zë të modës kanë prezantuar koleksionet e tyre në pasarelat e rjohura ndërkombëtare, duke u ndalur në detajet e viteve '70.

Po, pantalonat dhe të brendshmet mund t'i rikthejmë por ama urtësinë pereniale jo, assesi, pasi ajo është rigide, retrograde, e prapambetur...! Shpirti që ngërthehet nga koha dhe hapësira, për ne, është i vjetër, dhe i mbyllur në kafazin e hekurt. Ai ka të drejtë të përdoret vetëm për poezi, ndonjë fjali joshëse dashurie dhe në marginat e shoqërisë. Ai nuk guxon të depërtojë në universitet, në teatër, në shkollë e mos të diskutojmë në organizimin dhe udhëheqjen e shoqërisë.

Shpirti është një burim i gjërë dhe përfshirës që ka mundësi të zgjatet në të gjitha anët e jetës së njeriut. Si rrjedhojë, shpirti ashtu siç ka mundësi ta sistemojë fenë, metafizikën, filozofinë, artin, ashtu ka mundësi që të ndihmojë, madje edhe t'i qetësojë relacionet ekonomike, arsimore, shoqërore. Në traditën perenniale çështjet shoqërore zbatoheshin pas pjekjes në furrën e gnostikëve me urtësi dhe mençuri të thellë. Mendimi nuk udhëhiqej nga ngjarjet, përkundrazi pa pasur mendim nuk kishte edhe zbatim. Brend'i paraqitej në kuadër të një mendimi apo shkolle të caktuar filozofike, artistike, fetare, ndërsa tash individët bëhen "idhuj" me një këngë në të cilën përsëriten tre fjalë në 25 minuta! Praktika ishte reflektim i mendimit të pjekur me përvojë, ndërsa tash është rrjedhojë e konkluzave të nxjerra nga sjelljet të dala në pah nga statistikat. Ky është shkaku që edhe shumica e sémundjeve shpirtërore/psikosomatike nuk kanë shërim, por mbulohen me hi nëpërmjet medikamenteve qetësuese. Kjo kështu pasi psikologjia bashkëkohore nuk është më dije për shpirtin por shkencë e cila studion manifestimet e shpirtit.

Pse ende sot e kësaj dite ta lexojmë Hafizin, Sadi Shiraziun, Mevlana Xhelaluddin Rumiun, Platonin, Konfucion, madje edhe të botojmë libra me tituj "Platon i gjallë", "Konfucio në vend të punës", "Zhvillimi individual dhe Tao", "Dyzet ditë në halvet- Ditari i halvetit i një psikologje dervishe dhe zërthimi shkençor i tij" (Michaela Ozelsel)?

Shpirti në konceptin e urtësisë perenniale, kështu edhe në mendimin tradicional islam, gjithnjë i ka paraprirë veprës. Kur'ani shpesh thotë: "... që ta përkujtoni"; "... a nuk persiatni?"; "... a mos vallë i keni të mbyllura me dry zemrat?". Për fat të keq kjo traditë e mendimit dhe shpirtërisë në kohën e re u zëvendësua me shenjtërim të akcionit dhe si rrjedhojë edhe në hapësirat ku duhet, doemos, të dominojë shpirti u themeluan organizata që veprojnë vetëm duke i ndjekur ngjarjet. Kjo mënyrë e sjelljes shërben vetëm për

ta futur në kafaz shpirtin dhe për të mos i lejuar atij që ta përfjetojë kënaqësinë e lirisë jashtë trupit, jashtë lëndës.

Mos të flasim për politikën, aty fjala e parë do të jetë "Leri këto ideale se për ideale vdesin vetëm të marrët", ndërsa fakti është se pa ideale lindin dhe jetojnë vetëm të retarduar...

Qeniet në gjithësi nuk janë vetëm një grumbull i gjérave pa identitet dhe esencë, ata në "fytyrën e vërtetë" të tyre, pra subjektive, e kanë veten e tyre. Ata janë identitetet individuale dhe e shfrytëzojnë identitetin e tyre për ta kompletuar funksionin e dukshëm ngjashëm siç inxhinieri i shfrytëzon pjesët e ndryshme për ta kompletuar kompjuterin. Qeniet në gjithësi, njëkohësisht, janë edhe inxhinierë edhe makinë, pianistë dhe piano... Shpirti i fryrë në esencën e gjithësës është prapavija që ia mundëson gjallërinë qenieve në ekzistencë dhe "ana e vërtetë" e saj është e përfaqësuar si fushë e vëtëdijes. Sa më e sforuar është vëtëdija për origjinën e gjérave aq më shumë qenia ka mundësi ta kompletojë kompozicionin e të vërtetës në ekzistencë. Pasuria e udhëzimeve për përbërjet e ndryshme- veçanërisht tek njeriu, ku kujtesa artistike dhe kulturologjike i shtohet kujtesës biologjike- e mundëson që ta zbirthejë edhe atë që nuk mund të ndahet. Në këtë rast shpirti paraqitet si një inxhinier, i njeriut shpirt në njeriun trup, i furnizuar me mijëra udhëzime për bashkime dhe ndarje përmes të cilave del në dukshëm arti esencial i gjithësës. Për rrjedhojë, shpirtit është shfrytëzues transcedental i përmasës imanente ngjashëm siç pianisti që e shfrytëzon pianon e tij. Gnoza mbinatyrore në këtë rast imagjinon forma të gjalla dhe tejet të komplikuara, që në realitet edhe e paraqesin sfondin real artistik në gjithësi. Si pasojë e kësaj shpirtit është shndërruar në një qenie veta-nake, e përbërë nga llojlojshmëria e bashkimeve dhe ndarjeve të mundshme, në të gjitha format ekzistuese në gjithësi.

Feja (politeizmi, krishterimi, Islami) në periudhën paraantike dhe në mesjetë është konsideruar si modalitet i qenies dhe ka qenë një nga konceptet themelore të epistemologjisë. Egjiptasit e vjetër, hindusët, kinezët, filozofia hebreje, krishtere, islamë deri në shekullin e XV përmes konceptit fetar janë përpjekur t'i paraqesin përbërjet metafizike dhe si e tillë ajo ka qenë bazë për ndërtimin e ontologjisë në kuadër të sistereve të tyre filozofike dhe artistike. Gjithashtu, feja dhe ortopraktika në analizën dhe përkujtimet e klasikëve ka pasur për qëllim të shprehë animet e subjektit drejt objektit ose nga ana tjetër të jetë pasqyrim i emrave dhe atributave të Subjektit në Gjithësi. Si rrjedhojë, koncepti bashkëkohor se feja dhe ortopraktika janë akcidenta të objektit në periudhat para shekullit të XV janë konsideruar si të pabaza, madje disa herë edhe qesharake. Kjo kështu për shkak se një koncept i tillë është në kundërshtim me çështjen e reciprocitetit të metafizikës me fizikën dhe me

inkuadrumin e Subjektit në objektet, që mendësia klasike e ka konsideruar si të pabazë dhe në kundërshtim me konceptin e dijes dhe epistemologjinë reale. Dija e objektit në vete dhe pa asnjë inkuadrim nga më lartë e ngërthen rrezikun e përfash-timit të esencës nga vetë lënda; për shkak se lidhshmëria esenciale qëndron si relacion jashtë përmasës lëndore të objektit dhe objekti pa këtë lidhje është një akcidencë tejet e dobët dhe e pabazë. Gjithashtu, objektit metafizike para se të parafytyrohen nga arsyja ose shija kanë edhe një përmbajtje që nuk është lëndë e epistemologjisë; pra, konceptimi i objektit pa këtë përmasë esenciale është në kundërshtim me përkapjen intelektuale dhe aksilogjike të qenies. Pikerishit për këtë e mësipërmja është konsideruar si e pabazë dhe alternativa kryesore klasike për konceptim real të esencës së fesë dhe pragmatizmit të ekzistencës së qenies është bërë teoria e dijes metaforike, pra përfaqësimi i Qenies në ekzistencë si Vepru (Fail).

Në realitet ky koncept klasik i fesë dhe shpirtit ose vëtrnisë pozitive në Gjithësi është një zgjatje logjike e ontologjisë aksilogjike. Për pasojë koncepti i vlerës (value) është i realizueshmëri vetëm me përfaqësimin e qenies përmes veprës në relacion me Zotin. Në një mënyrë ky konstatim është i lidhur ngushtë edhe me vëtëdijen individuale. Vëtëdija-ashtu siç e përdor edhe Husserl'i- do të thotë që intelekti njerëzor të jetë i hapur, gjithnjë, përdicë nga jashtë, të ketë mundësi orientimi drejt diçkaje jashtë vetes dhe që nuk ka mundësi të ekzistencës nga vetja.

Çështja e veprimit fetar si pasojë e vëtëdijes në filozofinë sufike islamë është emërtuar me termin vëxhd. Vëxhd në aspekt gjuhësor do të thotë "dalje nga vetja fizike/ekstazë" dhe gjetje e të të Vërtetës/Zotit. Ibn Arabiu do të konstatojë se mendimi i shumicës së sufive është që qenia/vuxhud është gjetje e të Vërtetës në daljen nga vetja. Këtu gjithsesi etimologjia e fjalës vuxhud, që në gjuhën arabe e ka kuptimin e gjetjes ka ndikuar dukshëm në formësimin e kësaj teorie. Ndërsa vëtëdija/vixhdan është një gjendje e veçantë e gjetjes/vuxhud, por edhe e daljes nga vetja/vëxhd, si pasojë e paraqet pasqyrimin e befasës së Zotit në Gjithësi.

Termi vëxhd rrjedh nga rrënja "v-xh-d" që d.t.th.: gjetje e gjësë së humbur, hidhërim, dëshpërim, ankesë, bollëk dhe pasuri, potencial, dashuri e tepërt.

Vëxhd në terminologjinë e Tesavvufit paraqet hapjen dhe emociionimin e zemrës së udhëtarit shpirtëror gjatë vrojtimit të pasqyrimeve eterne të Allahut xh.sh., kalimin e tij prej vetes dhe qëndrimin bashkë me më të Madhin. Si rrjedhim udhëtarit shpirtëror i përfjeton fenanë (shkrirjen kuptimore) dhe bekancë (përhershshmërinë e besimit), "gjetjen e Allahut dhe shlyerjen e cilësive fizike të tij (sufiut)".

Në Tesavvufin islam dhe në disa siste me tjera mistike ekstaza është mjet e assesi qëllim. Qëllimi i jetës së mistikut nuk është ekstaza por është

vendi deri te i cili arrihet nëpërmjet saj. Në një anekdotë të përcjellë nga Huxhviri thuhet: "Një ditë Imam Shibliu në gjendje të ekstazës erdhë te Imam Xhunejdi dhe e vërejtë se ai ishte i dëshpëruar. E pyeti se pse ishte i dëshpëruar, ndërsa Xhunejdi i tha: Ai që kërkon do ta gjej! Kurse Shibliu iu përgjigji: Jo, ai që e gjen do ta kërkojë. Xhunejdi kishte të drejtë, thotë Huxhviri, për arsyen se ai fliste për ekstazën (vexhd), ndërsa Shibliu bënte fjalë për ekzistencën (vuxhud) dhe pohonte se njeriut nuk i kalon dëshpërimi përderisa nuk shkrihet në Qenien të cilën e adhuron.

Pika e fundit e vexhdit në Tesavvufin islam është Tevhidi (vërtetimi i njëshmërisë së Allahut). Domethënë e Tevhidit nuk është inkarnim ose unjësim me Zotin, por është njohje e njëshmërisë së Tij. Si rrjedhim njohja e cila paraqitet si rezultat i vexhdit, njeriun e abstracion nga vëtvetja dhe bota që e rrëthon dhe ai nuk ndjenë asgjë tjetër përvëç Allahut xh.sh. Kështu Zoti paraqitet si i vetmi Sundues dhe i Pranishëm në arenën e ekzistencës. Kjo d.t.th., që njeriu të mos shohë asgjë dhe në mendimet e tij të mos ketë asgjë përvëç Allahut.

Sa më shumë që thelohet dalja nga vetja, aq më shumë udhëtar shpirtëror vazhdon të sillet vërdallë në lugnat e mahnitjes dhe të madhështisë. Një çast vjen dhe e humb në tërësi dëshirën dhe vëten e sheh si një hije të dritës së qenies. Sun'ullah Gajbiu, një sufi me emër, i varrosur në Kutahja të Turqisë, në një poezi të tij shumë qartë e ka sqaruar këtë gjendje të gjetjes së qenies jashtë vetes dhe shprehjen e saj përmes veprës artistike. Ai thotë:

Mos u deh vazhdimisht me ashkun, por as mos u esëllø vazhdimisht me arsyen

Bashkoji hapësirat e askezës e të gnosës dhe përqendrohu

Xhelali/madhështia dhe xhemali/bukuria të bashkuara e mbajnë në këmbë këtë botë

Mos u dëshpëro pandërpërë në këtë kohë dhe as mos u gëzo pa nda

Në helmin e shumësisë është përzier sheqeri i njëshmërisë

A mos, vallë, pastën e madhe e shjoi Gajbiu dhe u përqendrua.

Megjithatë, këta kualifikime, do të mund të vendosen më shumë në planin shpirtëror të orientimit drejt Subjektit, sesa në qortim të 'shastisjes', që ju adresohet poetëve dhe artistëve me mungesë të orientimit intelektual kontemplativ. Për më shumë, fetaria dhe veprimi shqëror që nuk është i lidhur me Realitetin Ultimativ, vetëm se shpreh kësini, dhe më këtë i shkakton artistit 'hipokrizinë' esenciale, duke ia pozicionuar në vëtvete dy realitetë të kundërtë dhe të ndara plotësish, pra: atë të "të thënët" dhe atë të "përfjetuarit". E ndarë nga "të përfjetuarit", "e thëna" vlen jo më shumë se hiç, pra, humb realitetin ontologjik dhe atë shpirtëror dhe me këtë zbret në domenin e "të bërit të kotë". Përderisa është e abstenuar nga cilido realitet ontologjik, atëherë kjo 'e bërë e kotë' është tamam opozita e vetë objektit.

KRYQËZIMI NË NJË UDHEËKRYQ

Personazhet e autorëve posthomerikë Virgjit, Dantes, Shekspirit, Servantesit, Gëtes në udhëtimin e tyre nuk mund të shhangnin gjurmët e dy udhëtimeve të para në letërsinë botërore: të akejve drejt Trojës dhe të Odisesë nga Troja drejt Itakës



Yzedin HIMA

(Vijon prej numrit tē kaluar)

Udhëtimi i katërt në letërsinë euro-piane është nga më të ndritshmit. Tani ky udhëtim imagjinar nuk ndiqet nga lart nga çeta e zotave të Olimpit, por nga një Zot i vetëm. Nuk dihet se cili ka qënë mendimi i Dantes për Homerin, gjeniu analfabet, mësuesin e të gjithë poetëve ndër kohëra, por ndikimi i tij te poeti i Komedisë Hyjnore është i prekshëm. Udhëtimet homerike nisin nga Perëndimi drejt Lindjes dhe sërisht nga Lindja drejt Perëndimit, ndërsa udhëtimi dantesk nis nga kjo botë dhe vazhdon në botën e amëshuar. E përbashkëta është përpjekja mbin-jerëzore për t'u përsosur në të dy përmasat: në përmasën shpirtërore dhe në atë mendore për të qënë i denjë për t'u përballur me të bukurën. Helena, Penelopa, Beatriçja janë gratë rrezatuese që ndritin udhëtimin e subjekteve poetike, frymëzuar nga bukuria e tyre. Udhëtimet homerike zgjasin secili nga dhjetë vjet, ndërsa udhëtimi dantesk zgjat vetëm shtatë ditë. Dante, personazh e autor njëkohësisht, e nis udhëtimin pikërisht i lodhur dhe i zvenitur ngajeta e njëmëndët e kësaj bote: /Në mes të shtegëtisë së kësaj jete/ u gjeta në një pyll krejt errësi,/ se kishe humbë unë

rrugën e vërtetë./ Në udhëtimin e tij
Dante ka zgjedhur si mësues poetin e
antikitetit romak, Virgjinlin, ndërsa si
mësuese shpirtërore ka zgjedhur
Beatriçen, me bukuri e hire hyjnore. E
kishte dashur Beatriçen në rininë e
tij, kur bëri premitimin e famshëm se
për ndër të saj do të thurte një vepër të
lartë dhe do t'i këndonte siç nuk qe
kënduar më parë për nië grua.

Vdekja e Beatriçes e përcaktoi udhëtimin imagjinar dantesk nga kjo botë për te bota e amëshuar. Nuk e marrim dot me mend se në cilën formë do të nyjetohej Komedja Hyjnore, nëse Beatriçja nuk do largohet aq shpejt nga kjo jetë, ndonëse Dantja që betuar për veprën e tij në gjallje të saj. Ndoshta nuk do të qe shkruar fare dhe njerëzimit do t'i mungonte një mrekulli si Komedja Hyjnore.

Për t'iu afruar Beatriçes, për t'u ngjitur në Parajsë, aty ku rri Zoti, Dantja lipsej të ishte i denjë në të dy përmasat njerëzore: në mendje dhe shpirt. Sfida për t'u përballuar me Beatriçen e detyroi Danten të kërkonte mësuesin më të mirë që kishte njohur dhe njihte. Ky mësues që do t'i ndritte mendjen ishte Virgjili, me të cilin kishin një largësi kohore prej trembëdhjetë shekujsh. Po pse zgjodhi pikërisht Virgjinin dhe nuk zgjodhi një mjeshtër bashkëkohor?! Ndoshta ka qënë i vtdijshëm se më i

dijshi i kohës së tij ishte ai vetë. Kjo pyetje është pa vend nëse kemi para-sysh: Shekspiri a nuk i zgjodhi mësuesit e tij te tragjikët e famshëm grekë? Po njerëzit e sotëm a nuk i kërkojnë dhe i zgjedhim mësuesit e tyre më të mirë në thellësi të kohrave?! Cili nga ne nuk do të preferonte para mësuesve të kohës sonë një mësues si Platoni, Shekspiri apo Dostojevski?! Virgjili pati durim-in pët t'i shpjeguar e ftiluar të gjitha enigmat e asaj bote, por edhe Dante pati durimin dhe këmbënguljen për të mësuar: "/thashë: "O mësues, çfarë peshe heqë do të jetë / nga trupi im, i randë deri tanji, / që po më bahet si me pasë vu fletë?" Dantja, me ç'duket, ndihet një copë shkëmbi i palatuar, para se të takohej me Virgjinin. Padija i rëndon. Dante e sheh padijen si rëndesë që e pengon njeriun të ecë shpejt. Duke ndriçuar mendjen e flak tej rëndesën dhe ndihet me flatra. Mësimet e Virgjilit e gdhendin, duke i hequr pjesët e tepërtë, për t'u shfaqur më pas fytyra e tij njerëzore. Nuk thuhet kot që mësuesit e vërtetë lënë pas venës njerëzore.

Poeti i famshëm i Eneidës do ta përsoste Danten në përmasën mendore. Ai ishte i dijshëm dhe kurrë nuk u lodh së shpjeguari nxënësit të tij Ferrin dhe Purgatorin: /"Një hap mos e ço bosh" – më tha prisi i ndritun../ Ky varg duhet shkruar në vetdijen e

çdo njeriu, që në çastet kur ai nis të hedhë hapat e parë. Dhe kur përmasa njerëzore e dijes u plotësua, lipsej të plotësohej përmasa shpirtërore. Beatriçja me dritën e hireve të saj i formon Dantes një shpirt të lartë, larg mëkateve e ndotjeve të përkohëshmërisë tokësore. Ka një raport interesant në veprën danteske: sa më shumë përsoset subjekti poetik në të dy përmasat, aq më e bukur i shfaqet Beatriçja. Është magjia e dijes dhe përfjetimit, e edukimit të shijeve të holla estetike, që e pajis subjektin mendues me ato "shqisa" tepër, të cilat mungojnë te njeriu i pakultivuar, te njeriu i pailuminuar. Udhëtimi i Dante Aligerit përfundon me përballjen e tij me Beatriçen. Sfida e përballjes me të bukurën që realizuar mrekullisht: Dantja i denjë takohet me Beatriçen, ndërsa njerëzimi do të kishte në duar një vepër të paarritshme për nga forma e nyjëtimit dhe forca e frymëzimit për të qenë vërtetë njeri.

Udhëtimi i pestë është ndoshta ndër udhëtimet më tragjike dhe njëherësh më komike që mund të ndeshim në letërsi. Romani i Servantesit "Don Kishoti i Mançës" na rrëfen për udhëtimin e një personazhi të papërsëritshëm në letërsinë botërore. Don Kishoti, pasi e "përsos" mendjen dhe shpirtin e tij me letërsi kalor-siakë, ndihet gati për të kryer vepra të

mëdha, sikurse sivëllezërit e tij të një kohe të perënduar. Ai do të ndryshojë botën, ta bëjë atë më të mirë, më të drejtë, më njerëzore. Qëllimi i tij është tejet fisnik, pavarësisht mjeteve qesharake. E nis këtë udhëtim me synimin për të ndrequar botën, por duket se qëllimi i tij kryesor është të sfidojë të gjithë kalorësit që vërtiten në mendjen e tij dhe të ndeshet me ta për të merituar vëmëndjen e bukuroshes eterike Dylqinjës së Tobozës. Pikërisht, Dylqinja e bukur, e projektuar veç në mendjen e tij, është shtysa e këtij udhëtimi. Për të qenë i denjë para saj, Don Kishoti i Mançës është gati të përballet me të gjitha sakrificat, të ndeshet me të gjithë kalorësit sivëllezër të tij, të cilët vraponin jo në botën e njëmëndët, por në fantazinë e tij. Vrapimi i tij, krahas marrëzive, jermi të pandreqshëm, ka dhe një dukuri fisnike, shenjtërimin e bukurisë, së cilës i blatohen të gjitha bëmat dhe përpjekjen për ta bëri botën më të bukur, të denjë për një zonjë si Dylqinja e Tobozës. Në romanin e Servantesit, ndryshe nga veprat e përmendura më lart, personazhi kryesor i kalon kufijtë e të mundshmes në sfidën e përballjes me të bukurën. Madje, Don Kishoti, ndryshe nga personazhet e lartpërmendur, i duhet ta krijojë të bukurën me fantazinë e tij pjellore.

Udhëtimi i gjashtë është tragjik. Shtysa e këtij udhëtimi ka përmasa të tjera. Tani e bukura nuk mishërohet te femra, por te bota, që lipset të përsoset me hiret e një femre të bukur, plot virthyte, larg vesit, krimit, hipokrizisë, mashtrimit, ligësisë, etjes për pushtet, mosmirënjojhes, etj. Hamleti, personazhi i famshëm i Shekspirit, i dashuruar me këtë lloj bote, takuar në libra dhe projektuar në fantazinë e tij, e shikon Ofelinë si një kriesë tepër të brishtë, një botë e bukur në miniaturë për të realizuar kredon e tij estetike, ndaj e shmang nga rruga e tij për ta ndrequar botën. Fantazia e tij ia kalon fantazisë së Don Kishotit, i cili kishte për kufij të fantazisë së tij këtë botë, ndërsa Hamleti me forcën e fantazisë së tij depërton edhe në botë të tjera. Fantazia e Hamletit merr përmasa kozmike, kur ai "e shalon" atë dhe udhëton në kohërat që do të vijnë, duke i caktur kufinj të qartë të mirës dhe të keqes, të bukurës dhe të shëmtuarës, të vërtetës dhe gjenjeshtrës, jo vetëm në një kohë, por për të gjitha kohërat. Gjeniu Shekspir zbulon se ç'është mirë e ç'është keq, jo vetëm në epokën e tij, por edhe në epokat që do të vijnë. Dhe të mendosh se raporti midis të mirës dhe të keqes, në rrjedhën e kohës përblyset, herëherë edhe brenda një dekade e jo gjatë shekujve. Udhëtimi i Hamletit i ngjet rjaft udhëtimit të Don Kishotit. Të dy duan të ndreqin botën, ta bëjnë atë më të bukur. Don Kishoti për aventure, ndërsa Hamleti për mision. Hamleti ka rënë në dashuri me botën, por me atë botën e tij të endërrt. Të dy janë të marrë. Edhe kufijtë e marrëzisë së tyre shtrihen edhe në kohë edhe në hapësirë. Të dy dështojnë në kohën e tashme, por të dy triumfojnë në kohën e ardhme. Projektimi i botës së bukur nga Hamleti ka dimesionet universale në kohë dhe hapësirë. Edhe sot thirrja e tij për ndreqjen e botës është mision i çdo njeriu të iluminuar që ndihet pakëz hamlet. Ndryshtë nga udhëtimet parendësse, udhëtimi i Hamletit përfundon tragjikisht. Endrra e tij për ta ndrequar

botën, pér ta bërë atë më të denjë pér tē jetuar u pércoll brezave të kohrave që do të vijnë. Bota nuk ishte e denjë pér Hamletin apo Hamleti nuk ishte i denjë pér botën?! Mos vallë ai i pérkiste një tjetër bote që do vinte shumë kohë më pas? Edhe bota u pérpoq pér ta ndryshuar Hamletin, pér ta bërë atë më realist, më pragmatist. Nga Hamleti lipsej një kompromis i tillë: të bënte sikur nuk kuptonte, sikur nuk meditonte, sikur nuk dyshonte dhe gjithçka do të rridhte në hullitë e kohës së patrazuar. Hamleti do të realizonte përshpirtjen pér tē atin, do të përkulej me nderim para mbretit, ungjit tē tij, do përqafonte nënën e tij dhe do të nisej pér në Vytemberg bashkë me mikun e tij, Horatin. Koha sërisht do të punote pér tē. Më pas ai do të trashëgonte fronin dhe bota nuk do të dridhej nga disa të vërteta që rrallë herë dalin në dritë të diellit. Hamleti zgjodhi tē pérballëj. Nuk besoj se ka ndonjë që tē mendojë se në përsosjen e botës vit pas viti, dekadë pas dekade, shekull pas shekulli, nuk ka ndikur edhe mendja dhe shpirti i trazuar i Hamletit, dilemat e tij, neveria e tij pér tē shëmtuarën, shfaqur nëpër skenat e teatrove të botës. Në çdo teatër tē botës gjendet një qyngje e padukshme që lidh platenë me qyngjet e ujrave të zeza. Aty, gjatë dhe menjëherë pas çdo shfaqjeje teatrorë, rrjedh zgjyra e ndotjes shpitërore dhe zgjyra e ndotjes mendore tē qytetarëve të pranishëm, pas katarsisit të shkaktuar nga arti, doemos ai shekspirian. E natyrish, gjatë viteve, gjatë shekujuve ky proces nuk u ndal dhe bota u bë më pastër, bota u bë me e mirë, bota u bë më e bukur, bota u bë më e jetueshme. Aty u nyjtua qytetërimi, Europa moderne.

Udhëtimi i shtatë është një nga më interesantët në letërsinë botërore dhe vjen përmes një vepre të mrekullueshme siç është "Fausti" i J. V. Gëtes. Në dallim nga udhëtimet pararendëse, udhëtimi i personazhit të tragjedisë "Fausti", krahasuar me udhëtimet e personazheve të Homerit, Virgilit, Dantes, Servantesit, Shekspirit, zgjat gjatë më shumë se një jetë njerëzore. Fausti udhëtoi në shtratin e lumit tē dijes dhe në fund tē jetës vuri re se nuk kishte depërtuar në misteret e natyrës as me dijet shkençore, as me magjitet. Ndërkohë që kishte ndriçuar mendjen, kishte lënë pas dore shpirtin. I zhgënjer ngajeta e njëanshme vendosi t'i japë fund jetës. Në atë tē ditë tē lume tē Pashkës e shpëtuau nga vetvrasja tingujt e kambanave që lajmëronin ringjalljen e Jezu Krishtit. Më tej jeta e tij do të vazhdojë në kurbën midis baltës dhe qiellit, midis djallit dhe Zotit, si bast i tyre se kush do ta fitojë shpirtin e Faustit. Fausti, me udhëtimin e tij, shënoi gjurmët njerëzore në kohë, gjurmë tē pashlyeshme, si shenja të rrugëve që lipset tē ndjekë njeriu i ardhshëm pér tē arritur sublimen në fund tē jetës së tij. I vedijs hënë që ishte gjeni, Gëtja e gjeti pér detyrë që me një vepër tē përkryer artistike t'i jepte qytetërimit botëror "guidën" që duhet tē ndiqte pér t'u realizuar në tē gjitha përmasat njerëzore. Vetë vepra dhe jeta e Gëtes janë shembull i shkëlqyer i mundësive njerëzore, punës së mundimshme dhe arritjes në lartësi tē tillë, ku njeriu ndihet njeri dhe prek lumturinë. Jeta e Faustit dhe jeta e Gëtes ngjajnë si dy pikë uji. Te ky udhëtim nuk mungon edhe gruaja që bëhet ylli polar në rrugën e

heroit drejt përsosjes. Ajo grua-dritë
 është tepër lart dhe tepër larg, ndaj
 personazhi do të përballet me sfidida
 të njëpasnjëshme pér t'u ngritur lart
 dhe pér t'u përballur me të. A ka
 ngjashmëri midis udhëtimit të Faustit
 dhe udhëtimit të Dantes? Ngjashmëria
 është domethënëse. Edhe Fausti si Dantja e shikon
 udhëtimin jetësor si sfidë pér t'u
 përballur me të bukurën. Të dy
 personazhet kujdesen pér t'u përsos-
 sur në të dy përmasat, shpirtërore
 dhe intelektuale. Ka një përgjasim
 midis Beatriçes së Dantes dhe Mar-
 garitës së Gëtes. Janë të dyja burim i
 pashtershëm energje shpirtërore
 dhe virtuti. Edhe udhëtimi i Faustit i
 ngjet udhëtimit të Dantes. Të
 përbashkët kanë edhe çastin e
 rilindjes, ditën e Pashkës kur nis
 udhëtimi dantesk dhe në këtë ditë
 rilind në një dritë të re Fausti.
 Shoqërueshit e tyre ndryshojnë. Virgjili
 plot dritë dije dhe Mefistofeli plot
 drithma terri. Dante shkon te Ferri,
 ndërsa Ferri (Mefistofeli) vjen te
 Fausti. Nëse Virgjili e merr pér dore
 Danten dhe i tregon të fshehtat e
 përtejbotës, Mefistofeli nuk e lë të
 prehet asnjë çast Faustin, duke e
 nxitur drejt sfidave të reja. Ai është
 nata që e shtyn Faustin drejt dritës:
 ...unë nuk jam veçse një copë nga ajo
 copë, / e cila në fillim qe e gjitha./ Një
 copë e errësirës që ka pjellë dritën.../
 Janë fjalët e prezantimit të Mefis-
 tofelist te Fausti. Nëse Virgjili hedh
 dritë te skutat e errta të padiges së
 Dantes, Mefistofeli nxit pa ndalim
 energjitet krijuese dhe vepruese që
 flenë te Fausti. Në fakt, të dy
 personazhet janë vetja e dytë e
 Dantes dhe Faustit. Virgjili, poeti i
 madhërishëm, me veprën e tij
 poetike, është vetëdija e Dantes,
 frymëzuesi i tij pér zbulim, njohje,
 dije dhe përsosje mendore, ndërsa
 Mefistofeli është vetja djallëzore e
 Faustit, e keqja e domosdoshme pér
 t'u ndeshur dhe pér t'u ngjitur drejt
 sublimes në luftë më të ultën, vulgar-
 en, limontinë. Kur shfaqet Helena,
 ikona e përjetshme e bukurisë
 femërore, Fausti gurëzohet nga
 bukuria: Kam ende sy? Në shpirtin
 tim a s'derdhet / më i pasuri burim i
 Bukurisë? / Udhëtimi i frikshëm më
 pru lumturinë, / përparrë bota s'ish
 pér mua asgjë / ... Ty t'i kushtoj fuqitë
 e shpirtit tim, / ngalljen e ndjenjave
 të zjarra / dhe dashurinë, lutjet,
 adhurimin. / (Fausti, fq. 371) Nata e
 Valpurgës klasike e përgatit Faustin
 pér t'u përballur me Helenën e
 Spartës. Ndërsa prek truallin klasik,
 Fausti fiton energji të pazakonta: ...
 Ky ësht' ajri që thithë zën' e saj / këtu
 jam, si pér çudi, në tokën greke! (Fausti,
 fq. 403) Takimi me Hironin,
 mësuesin e Akilit, Jazonit, Heraklit
 dhe Asklepit i jep përvojën e artit që
 nga lashtësia e largët deri te periudha
 e ndritshme klasike greke. Në dialogun
 me Hironin pér Helenën, Fausti
 thotë: Vajzë - e rrëmbejnë; plakë - e
 dashurojnë. / Poitin nuk e lidh askur-
 rë kohal! / ... E pe qëmoti ti, sot e pashë
 unë. E bukur sa hirplotë, sa joshëse aq
 e bukur. Bukuria, me ç'dukët, është
 materiali më i qendrueshëm. Nuk e
 zbehin shekujt. Ajo është pikture e
 mrekullueshmë në kanavacën e
 kohës. Doktor Fausti e ndërtón,
 e materializon shtatin e saj me mallin
 dhe adhurimin e tij pér të bukurën.
 Natyrish, Nata klasike e Valpurgës e
 ka paisur mendjen dhe shpirtin e tij
 me të gjitha instrumentat e percepti-
 mit dhe krijimit të së bukurës: Si

s'mundem unë me mallin tim të zjarrtë / ta sjell në jetë shtatin e pashoqtë? / Atë krijesë hyjnore, të amshuar. /(Fausti, fq. 421) Udhëtimi i Faustit është udhëtim progresiv dhe digresiv. Ai shkon nga mesjeta në antikitet, me lehtësinë e "vrapit" të mendjes së njeriut, pa asnjë pengesë. Ai e fiton sfidën për t'u përballur me të bukurën, falë eksperiencës së tij intelektuale dhe shpirtërore: Oh, mos e përcmo, o zonjë e madhërishme, / dhuntnë tëndë aq të rrallë, / se vetëm ti ke fatin më të ndritur, / lavdinë e Bukurisë që sundon gjithçka./ ... Por edhe më kryeneçi burrë përkulet / para gjithmonëngjadhnyses Bukuri. / (Fausti, fq. 473)./

Shigjetat e dashurisë që shpërndan Helena e kanë plagosur rëndë shpirtin e Faustit. Ato shigjeta kanë udhëtuar në kohë, apo Helena jeton te çdo grua e bukur, në cilëndo kohë? Helena është aq e bukur, sa i shiton njerëzit që janë në rrezen e saj të bukurisë. Linkeu, symprehti, i goditur nga bukuria, harron të lajmërojë ardhjen e Helenës. Njihet te folklori ynë magjepsja nga bukuria e zanës. Përbalilja me të bukurën kërkon energji të mëdhe. Faustit, në përballjen me Helenën, i ikën fryma, i ikën zëri, humb vetëdijen, çorintohet deri në atë masë sa humb përmasën hapësinore dhe atë kohore: Mezi marr frymë, fuqi të flas nuk kam; / si në endërr, s'di në ç'vend e kohë jam. (Fausti, fq. 511). Nga fundi i tragjedisë shfaqet edhe një mesazh i drejt-përdrejtë i Gëtes: ...Veç ai e meriton hirin e grave / i cili di t'i mbrojë trimërisht. /

Po atë dritë bukurie zjarrmuese të Helenës e hijezon vetëm një grua pér syrin e mprehtë të Faustit, Margarita. Po cila éshtë "arma" e saj? Energja e bukurisë së Helenës e ka burimin te pamja, ndërsa energja e bukurisë së Margaritës éshtë shumë më e thellë dhe shumë më e qëndrueshme dhe depërtuese. Ajo buron nga shpirti i saj. Drita vjen së brëndshmi dhe depërtin jo vetëm te syri, por pushton mendjen dhe zemrën e burrit. Bukuria e jashtme e lë zemrën të ftohtë, ndaj Fausti, i cili nuk ia shiti shpirtin djallit, pra Mefistofelit, i denjë pér t'u përballur me bukuri shpirti, ngjitet lart në parajsë dhe bashkohet me Margaritën, sikurse Dantja me Beatriçen. Kur i shfaqet Margarita, zbehet bukuria drithëruese e Helenës: ...Ajo lëshonte dritë më fort se çdo thesar... (Fausti, fq. 541.) Bukuria e Margaritës nuk éshtë thjesht bukuri, por mbart edhe vlera virtuti, ndaj Fausti e shikon dritën e saj si dritë thesari. Pas punës në dobi të njerëzve, Fausti njoblu lumburinë që sjell altruizmi te mendjet dhe shpirrat e kultivuar. Kjo lumburi kurorëzihet pikërisht me bashkimin e shpirtit faustian me Margaritën: Ajo që s'arrihet / Veç këtu gjen plotesi. / Gjithçka e pashpjegueshme / këtu éshtë krejt e qartë: / e amshueshmja femërore / na tèrheq gjithnjë lart. / (Fausti, fq. 635)

Personazhet e autorëve posthomericë Virgjit, Dantes, Shekspirit, Servantesit, Gëtes në udhëtimin e tyre nuk mund të shmangnin gjurmët e dy udhëtimeve të para në letërsinë botërore: të akejve drejt Trojës dhe të Odisesë nga Troja drejt Itakës. Të gjitha udhët e tyre do të kryqëzoheshin në një udhëkryq, në antikitetin grek, aty ku nisin të gjitha udhët e endjes së peronazheve të letërsisë botërore. (Fund)

“ZANORET” E ARTUR REMBOSE


Vetém 19 vjeçar. Pas kësaj moshe, ai nuk do të shkruante asnë varg. E imagjinoni dot se ç’do të kishte bërë Rembo me veten dhe me talentin e tij, nëse do të kish vazhduar të shkruante?

Majlinda NANA

Art i vështirë dhe forma e përsosur - ja se çfarë ishte epikendër e simbolistëve, të cilët nuk shihninasnë pikë takimi me realizmin, sikurse ishin dhe anti prozës. Ishte domosdoshmërisht e vlefshme ajo që Malarmeja do ta shpërfshaqte si manifest në një nga artikulimet e tij, që tregonte ashiqare pikërisht orientimin poetik të simbolistëve: “Poezia është shprehja nëpërmjet ligjërimit njerëzor të kthyer në ritmin e vet esencial, e kuptimit të mistershëm të aspektave të ekzistencës; ajo i jep kështu autencitetin jetës sonë dhe përbën një detyrë shpirtërore”. (Stefan Malarme, “Letër e qershoret”, 1884). Në të vërtetë, simbolizmi tentoi qysh në fillesat e veta për një kundërvënie të theksuar ndaj realizmit, parë kjo sidomos në nivelin e këndvështrimit dhe të ndërtimit formëshprehës. Asnjë lidhje me realitetin dhe larg prozaizmit. Poezia jo përshkruese, por evokuese e ritmeve, e figuracionit, e përjetimeve emotive plot lëvizje e gjallim, e ndjesive, imazheve, e një perceptimi te realiteteve të tërthorta, ana intuitive, kahu drejt autoanalizës psikologjike, emblemizimi i sendeve dhe objekteve me mister dhe synimi i shndërrimit të tyre drejt simbolit, drejt universalizimit të qenies - të gjitha këto kanë krijuar paradigmë e simbolizmit, duke shkaguar gjithçka të realizmit.

Vetém 19 vjeçar. Pas kësaj moshe, ai nuk do të shkruante asnë varg. E imagjinoni dot se ç’do të kishte bërë Rembo me veten dhe me talentin e tij, nëse do të kish vazhduar të shkruante? Dhe do të kishte një ngasje poetike që vinte si buresë thuajse imitative e poesisë së Hygoit e disi të parnasianëve në fillimet e veta, për t'u bërë më vonë ai që njohim të gjithë. Ishte ai, Artur Rembo, që do të zbulon elemente të veçantë dhe tepër harmonizuese midis ngjyrave dhe tingujve më të thukët të mundshëm, pa shkuar në zgjatime të rrokjezuara. Poezia e Rembosë sugjeron, lëviz lirshëm drejt figurimit ideor, asociacionet e fantazisë së poetit bashkëshkrihen në tingujt e muzikës dhe penelatave fine të pikturës.

Le të ndalemi te soneti me titullin “Zanore” i Artur Rembos, i njohur dhe si soneti i ngjyrave. Tingulli ngjyrë. A është tingulli ngjyrë? A është ngjyra tingull? A pikturopet tingulli? (Mjeshtri “gdhend” dirigueshëm pikturën më të madhe të poesisë muzikore). Rembo nuk e dinte mbasë se po e ngiste rrymën që do të identifikohej me emrin e tij, drejt hapësirave të reja, duke konturuar harmonizimin efektual dhe lidhjen koherente poezi - muzikë - pikturë. Dhe, pikërisht soneti “Zanore”, do të bëhej pika nistore e vëzhgimit të simbolistëve në ekzistencën e trekëndëshit poezi - muzikë - pikturë, alias: fomemëzanorësi - tingull - ngjyrë. Rembo dhe “Zanore” përbëjnë presedan për simbolizmin dhe mëtejësinë poetike botërore. Hyjmë në



detajet e poetimit të Rembos:

A është e zeza, E e bardha, I e kuqja, U e gjelbra,

Kurse O është bluaja:

të fshehtat e tyre do të shpjegoj tani,

A është parzmorja në trupin e insekteve të lehta'

që gumëzhinjë e vërtiten mbi plehrat në periferi.

Ç’ka vëzhguar Rembo? Nuk duhet harruar fakti që ai vjen nga provinca Charleville dhe është “zbulim” i Verlenit, pasi ftesa për t'u bashkuar me poetët parnasianë, provincialit Rembo do t'i vinte pikërisht prej Pol Verlenit.

A është e zeza...

A është parzmorja në trupin e insekteve të lehta'

që gumëzhinjë e vërtiten mbi plehrat në periferi.

A - e zezë. Është zanore “e myllur” nga ana “arkitektonike”. Nis nga “toka” dhe përfundon “në tokë”. Shihni dy skajet e saj, dy pikat e mbështetjes. Nisin dhe mbarojnë në të njëtin drejtim, ndërsa viza mesore midis dy shtyllëzimeve të zanores A është ai “parzmi” mburojë në trupin e “insekteve të lehta”. Vini re: ka hapësirë edhe përparravijës ndarëse - bashkuese të A-së, edhe përpas saj, ndaj janë “insekta të

lehta që gumëzhinjë mbi plehrat në periferi”. E, pra, Rembo e njihet mirë provincën, periferinë. E çfarë ngjyre jetë mund të kishte periferia? Dhe dita e një qyteti, zgjimi i një qyteti, A - ja, nistrojnë pikërisht nga pagjumësia e periferisë. Asociacion!

E e bardha....

E është e bardha e çarçafëve, spitaleve e mjegullave

e ajzbergëve madhështorë dhe miniaturave të fildishta...

Kontrast! Ndryshim “okordi”. “E e bardha...”. Le të vëmë re me kujdes: zanoria E ka një shtrirje horizontale dhe është hapësinore, shënuar simbolikisht me anë të mjegullës. A - e zezë, E - e bardhë, por kontrastimi shkon dhe nga bardhësia e çarçafëve te bardhësia e “ajzbergëve madhështorë”; nga madhështia e ajzbergëve te “miniaturat e fildishta”. I e kuqe dhe “gjaku i gjallë i plagëve dhe dhembjeve”. Ka një tingull të gjaktë, vertikal, përfytyruar në një gjatëçarje buze, për të cilat Rembo ngjyros si “të skuqura nga sharjet apo elozhet e trishta”, një e çarë ku, nuk është primare thellësia, por plaga dhe dhembja. Epiteti “e trishta” që metaforizohet për emrin “elozhet”, shpreh dhe një pjesë të mirë të karak-

terit të poetit, i cili nuk u bë dhe nuk u shfaq kurrë konformist, në asnjë moment. U - krijon përqasjen e duhur, duke relevuar me simplicitet ondulationin e dallgës, me pikëkulmin e kreshtës së saj dhe platinjen e tejfirjen e dallgës në brendësi të kaltërsisë së gjelbër të hapësirës së krijuar. U dhe « - është kjo forma që jep ondulimin midis hovjes, majëngjitet së dallgës dhe kthimit të saj sërisht në det. Dhe aty shfaqet një koncentrim e zërthim më subtil. Blu është edhe qelli që synon lartësia e kreshtës së dallgës. Dualiteti det - qill, por edhe më tepër se kaq, pasi aty ka një depërtim më të thellë e më të gjerë, në qartësinë e pastërholluar të natyrës, në tejësinë e luginave.

O është klithma e zogut, tronditëse, e pakupueshme,

Fluturimi i engjëjve në infinitet e amëshueshme,

O është rrezatimi i syve të tu të ndritur.

Kështu mylljet ky sonet. O - trëndafili qellor, por këtu me një rrëth jo të myllur, O - një klithmë dëshpëritare pasthirrmore e zogut, një “tronditje e pakupitët” dhe pastaj O - “rrezatimi i syve të tu të ndritur”. Ja, këtu kemi një rrëth të myllur në stacionin “nga sytë e tu - te sytë e tu”, një ovalitet që i vendos pikën gjithë poesisë muzikore piktografike të Rembosë me titullin “Zanore”. Është një lidhje onomatopeike, jo thjesht konvencionale e deduktive, sepse, edhe po të ndalesh në tingullimin zanorësor A, E, I, U, O, secila ka veçantinë e vet. Mendoj se Rembo nuk ka bërë trajtesë thjesht fonostilematike, por arti i tij, zanoret, tingulli komportohen në një ndijim të konceptuar përmes shqisave: prek, sheh, nuhat, frymon, aromon, pezullon...pastaj lëshon një tingull, një zanore. Edhe një fjali thirrmore: “O, sa e bukur!” ka një fillim zanorues: “O”. A ka një kod? Çfarë kërkonte të përcilte poezia simbolike? Ku qëndron e veçanta e saj? Këto janë pyetje që do të na grishin gjithherë, pavarësisht bindjes se Rembo e revolucionoi dhe e çoi në kulme të tjera retorikën dhe gjithë këtë lloj poezie e letërsie në tërësi. Ai (Rembo), një pikë apo shenjëz grafike që kérkon një anije që s'lodhet në det; Ai, krijimi i një lëvizjeje që sjell konfiguresën e shpërndarjes së patrjtë të reve në qill. Artur Rembo do të myllitë sytë një muaj e 10 ditë përparsë se të mbushtë 37 vjeç dhe gazetari Raymond Sokolov do të shkruante në “Neësday”: “...Artur Rembo kishte një emër të keq në jetën privatësore, do të thotë një emër pervers, të urryeshëm, qyqar...Por ai ishte gjithashu një nga poetët më të mëdhenj që ka jetuar ndonjëherë...” Për Rembonë, për poezinë e tij, për shpërthimin e beftë dhe nuancor të talentit të tij, për kontributin dhe ndikimin e Rembosë në gjithë letërsinë franceze, do të përzgjidhja për ta myllur shprehjen antologjike të Malarmes: “Një meteor që na ndriçoi ne dhe u zhduk”.

VARRIMI

Teki DĒRVISHI

Nga tē çarat e dërrasave, nē kaçorren ku fshiheshim, lehtë mund t'i hetoja njollat e gjakut, por ku ta merrja guxmin tē dilja përjashta e t'i lëpija. Nē kazermat e Gestapos, ushtarët ngaherë kishin ikur me ato kryqet e tyre tē thyer, dhe tē gjithë qentë e qytesës kishin mësyrë aty qē t'i lëpinin kutitë e thata tē konservave nē tē cilat akoma mund tē gjendej ndonjë pikë yndyrë pér t'u lëpirë. I thashë Baloshit se diç e çuditshme ndodhet atje nē qytesë dhe se nuk bënëm aspak mirë qē, edhe ne, nuk ishim atje, nē mesin e shokëve tanë, nē llavën e qenve tē uritur qē nuhatnin pas eshtrave dhe pas kutive tē thata tē konservave. Baloshi më tha se kështu, duke i futur hundët gjithkund, qentë tērbohen dhe pastaj sëmundja fashit ngado qē t'i vijë era. Kjo më bëri tē frikohesha, andaj nuk e luta më qē tē dilnim. Rrinim nē kaçorre me ditë tē tera, gjersa krejt kurrizi na u ngjit përbarku. I thashë pastaj Baloshit se edhe nga uria qenit fare lehtë mund t'i vijë bakcili i tērbimit. Ai u pajtua me mua, por nuk i mbushej mendja qē tē dilnim. I lutesha qē, së paku, tē dilnim dhe t'i mbllaçitnim ato plloha gjaku tē derdhura nē tokë, atje pas dërrasave tē kalbura tē kaçorres sonë, por ai frikohej nē mos edhe nē to, rastësish, jetonte ndonjë bakcil i tērbimit. Kalonin kështu ditët dhe, më nē fund, nuk ndiheshin më as krismat e pushkës, siç pushkalloni me radhë pér tri e më shumë vite. Qytesën e kishte kapluar një amulli heshtjeje, qē, vërtet, fliste pér tērbimin. Por, pér çudi, nuk na binte tē dëgjonim, së paku një herë tē vetme, ndonjë cijate apo lehje qensh. Thaujse vetëm unë e Baloshi kishim mbetur akoma nga e téré bota e qenve, e, edhe ne, aq tē pafuqi e po aq frikacakë, thaujse krejt soji i qenve kishte vdekur e ngordhur rrugëve tē pérbaltura tē qytesës, e kishim mbetur vetëm unë e Baloshi qē tē ruanim farën e tyre, duke heshtur e duke u frikuar nga ai bakcil i mallkuar i tērbimit. Nuk ma merrte mendja se mënyra si ruhej Baloshi nga ai bakcil ishte shumë fatlume. Po qē se s'bënëm diçka, po qē se s'dilnim pér tē gjetur ushqim duke u rezikuar madje edhe nga infektimi, me siguri se do tē na priste tehu i ngordhjes nga uria. Por Baloshi mendonte se më mirë ish tē ngordhni tē shëndoshë, se sa tē rrezikoheshim duke fryrë barkun me ndonjë ndyrësirë qē do tē na sémurte, e nē atë gjendje tērbimi edhe tē na bënte ta hanim njéri-tjetrin. Baloshi ishte më i vjetër dhe unë nuk guxoja t'ia ktheja fjalën, edhe pse më qe tharë fytë e shterë krejt barku urie. Prisnim kështu e nuk dinim se çfarë na priste. Baloshi ngriste herë pas here veshët e tij tē gjatë dhe përgjonte përjashta kaçorres, nē mos ndonjë njeri rrapellonte rastësish ndonjë konservë sardelesh a gaforresh. Por s'kishte gjë atje përjashta, nē qytesë. Thaujse qentë e botës qenë shfarosur krejt. Dikur, atje larg, nē kazermën e zbruzur, nisi një lehje e tmerrshme qensh. Baloshi menjëherë futi bishtin nën shalë dhe më tha se tērbimi, më nē fund, qe përhapur nē qytesë dhe se, nē se nuk i mbledhim tē gjitha forcat qē na kishim mbetur e tē iknim diku, patjetër do tē infektoheshim edhe ne dy. Pastaj i zgurdulloj sytë dhe, me bisht nën shalë, nisi tē ikte, por nuk ecte më shumë se një qen i sémurë. Unë i shkoja pas.

Kur dolëm nē rrugë, njeriu qē rrinte pranë ulluqeve tē ndotura duke ruajtur ujërat e tyre tē njelmëta qē tē mos futej nē to ndonjë i fisit tonë, na veneroi dhe na u lëshua pas duke u dhënë këmbëve



me vrap. S'do mend se na zuri shpejt, por nuk guxonë tē na ofrohej. Baloshi zuri t'i ngërdhuej me hungërima e me kërcëllimë dhëmbësh, por shihej qartë se kjo nuk e trempte njeriun. Ai veneroi fort mirë edhe barkun tonë tē ngjitur pér kurizin e thatë, e besa, fort mirë i shihe edhe sytë tanë qē s'kishin më as shkëndijën më tē vogël tē guximit, por shpërthenin nga ato dritëzat e tmerrshme tē frikës. Po tē mos frikohej nga mundësia se edhe ne mund tē ishim infektar nga bacili i tērbimit, me siguri, njeriu do tē kërcente e do tē na rrëmbente me tē dy duart e tij prej katallani. Por, fatbardhësish, frikohej, e këtë e shihnim qartë. Ne niseshim ngadalë përpara, duke dashur t'i iknim, e ai ngarendte pas nesh me nxitim; posa ne ndaleshim dhe Baloshi zinte t'i kërcënohej me dhëmbët e tij tē mprehtë, edhe ai ndalej menjëherë dhe priste se ç'do tē ndodhët. Por, nuk ndodhët asgjë e kobshme, kështu, duke ecur nga pak, e pastaj, duke u ndalur qē tē kërcënonim njeriun katallan, ne grabitëm një copë tē mirë rruge. Kjo, pa mëdyshje, e gëzonte Baloshin, por unë pér vete herët fillova tē brengosesa duke menduar se kah do tē shkonim dhe se a do tē na linte tē qetë ndonjëherë ky njeri i çuditshëm e katalan qē donte tē na fuste në kurth.

Kështu deri terri rëndoi mbi qytesë. Ishte një natë shumë e ftotë dhe kur koha filloj tē sosej me aq përtësë, unë, qē gjithnjë rrija prapa Baloshit qē kërcënohej me dhëmbë, pashë se si shkëlqenin sytë e katallanit, i cili as nuk donte tē na lëshonte e as tē na linte tē iknim. Kështu kaloj edhe nata, gjithnjë duke na përcjellë ajo dritë e çuditshme e syve tē katallanit. Ata shndrisnin si sy maçoku në terr.

Në agim u gjendem afér telave me gjemba tē kazermave tē zbræzëtë tē Gestaposë dhe unë fort mirë ia pashë pushkën njeriut katallan qē na përcillte. "E pat", mendova, por shpejt më ra ndërmend se ai, po tē kishte dashur, do tē na kishte vrarë kaherë. Megjithatë, nuk besoja se kisha tē drejtë, ndoshta nuk mund tē na vriste vetëm e vetëm qē tē mos ndihej krisma e pushkës së tij, e nga

ajo krismë tē llahtarisej pastaj krejt nahija, edhe ajo pértej qytesës sonë. E pyeta Baloshin qasur me këtë, por ai ishte i zënë duke kërcëllitur dhëmbët dhe as nuk u lodh tē më përgjigjej. E luta edhe një herë, por më kot. U binda se nuk e kishte ndërmend tē më tregonte asgjë, ndoshta qē tē mos më frikonte, ndoshta qē tē më linte gjithnjë tē shpresa, ose, vetë djalli do ta dijë pérse nuk ma tregonte Baloshi arsyen e çuditshme pse nuk na vriste njeriu katallan i cili gjithë natën na përcoli asnjëherë pa e hequr prej krahu atë pushkën e gjatë, madje as pér sa çel e mbyll sytë. Pastaj mësova se pér këtë duhej tē kujdesej Baloshi dhe se ai do tē më mbronte, duke e mbrojtur edhe veten, kështu qē nisi tē më bengoste përsëri puna e telave me gjemba. Tani qē kishim ardhur nē bythë tē tyre, nuk dinim se kah djallin t'ia mbanim. Këtë nuk mund ta dia assesi. Nuk e dija, por as nuk guxoja ta pyesa Baloshin. Ai ishte aq i zënë me tē kërcënuarit e tij, qē i bënte njeriut katallan, sa edhe një shpërqendrim tejet i vogël do tē ishte shumë i kobshëm. Rrinim ne, e rrinte para nesh, téré gjysmë ditën e dytë, njeriu katallan, me atë pushkën e tij tē gjatë, varur krahaqafë. Dikur i bëri disa hapa përpara. U zmbrapsëm, por duke shkuar skajit tē telave. Si duket u gjet më nē fund shtegdalja, mendova. Mirépo, kur dielli edhe pér disa ostena do tē zbriste nën Bjeshkët e Nemuna, e kuptova se uria po na i shteronte fuqitë e se kazermat e lëna tē Gestapos ishin tē rrumbullakëta, qē do tē thoshte se ndjekja do tē ishte e përjetshme dhe se nuk kishte shpresë aspak. Ky njeri katallan mund tē na vriste me pushkën e tij kur tē donte, por qe, e dija se tē rrumbullakëta ishin kazermat dhe ai s'kishte pse ta çonte plumbin kot; nuk i ngutej burrit katallan dhe e dinte se ne, nē mos sonë, natën qē po vinte, atëherë me siguri nesër do tē ngordhim urie, do tē na tērbonte bacili i sémundjes së qenve.

Kur ra, i dendur, edhe terri i natës së dytë, Baloshi më tha tē kacavaresha nēpér telat me gjemba tē kazermave tē lëna tē Gestaposë. Bëra si më tha dhe u gjenda matanë telave. Pastaj edhe

Baloshi erdhi pas meje. Tani filluam tē iknim nēpér terr drejt sheshit qē ishte atje, te ndërtesa dykatëshe me kulm llamarine tē bardhë qē shkëlqenit nga drita e hënës dhe, kur ktheva kokëna prapa qē tē shihja sytë qē shndrisnin si tē maçokut, u binda se katallani s'mund tē kacavarej nēpér tela dhe se nuk mundej as tē shtinte, pasi qē ishte terr i dendur. Sigurisht do tē jetë penduar shumë dhe do tē ketë plasur nga mëria.

Në sheshin afér shtëpisë me kulm prej llamarine qē pér tre vjet e më shumë qe vendbanim i Gestaposë, gjetëm disa konserva tē freskëta, tē sapoçelura, ku kishte pak yndyrë qē tē lëpinim. Baloshi ma ofroi së pari mua e më tha se ishte shumë e freskët dhe, si e tillë, me siguri s'mund tē ishte infektuar nga bacili i tērbimit. Pastaj shkoi duke nuhatur dhe u kthye edhe me disa tē tjerë qē kishin yndyrë edhe më shumë se kjo qē e lëpja unë. Filluam kështu tē lëpinim, unë e Baloshi, gjersa na u kthye fuqia krejt dhe, pas një haje kaq tē majme, më ra ndërmend se, tani, po na shkatërronte lodhja pér një sy gjumë. Ishin bërë dy net e dy ditë qē kur na ndiqte ai njeriu me atë pushkën e tij tē gjatë dhe, vetëm pasi e ngopëm barkun dhe ikëm prej tij, na u kujtua se, pa e bërë një sy gjumë - s'mund tē vazhdonim arratinë. Tani, nuk e di por mua më kujtohet vetëm çasti kur i hapa sytë dhe pashë diellin se si digjte nga kupa e qiellit. Baloshi akoma ishte nē gjumë, kurse rrëth nesh ishte grumbulluar një llavë e madhe qensh qē na shihnin me habi. Cijatrin dhe i zgërdhin dhëmbët e tyre, sikur nuk ishim edhe ne tē fisit tē tyre, sikur ishim ujq e jo qen. U dukej. Por nuk na ngacmonin. Ishin tē urtë dhe unë u binda se asnjëri nga ata nuk ishte infektuar nga bacili i tērbimit. Kur u zgjua edhe Baloshi i rrëthi u shpërndë pak, pamë se si, nēpér tē oborrin e kazerës, ishin shpërndarë qindra e mijëra konserva peshku e gaforresh tē freskëta, veneruan se si, secili nga qentë lëpinte nga një dhe kjo do tē thoshte se tē gjithë ishin tē ngopur. Nga e gjithë kjo qē pashë, u gëzova, por prisja tē gëzohej edhe Baloshi, i cili nisi ta luante bishtin me nxitim e tē cijaste nē kulm tē hidhërimit. "E patëm, e patëm", mendova unë, posa ndjeva këtë cijatje tē kobshme tē baloshit, sepse, ndonëse kishim kaluar rreziqe edhe më tē mëdha, kurë s'më kishte rënë ta dëgjoja Baloshi tē cijaste aq kobshëm. E pyeta pastaj, me sytë e mi tē llahtarisor, e ai, sipas shprehisë, as kësaj here nuk m'u përgjigj fare. Me gjasë, nuk donte tē më tmerronte, ose e dinte se edhe unë së shpejti do ta kuptoja tē vërtetën.

Ta merr mendja. Aty kah mesdita, ai njeriu katallan ia behu nē shesh, afér shtëpisë së Gestapos; nē dorë mbante atë pushkën e gjatë tē cilën nuk e shkrepët fare. Pas tij erdhën edhe shumë e shumë njerëz tē tjerë, po ashtu katallanë, tē cilët, sikurse edhe ai qē na kishte ndjekur, kishin varur krahaqafë pushkë tē gjatë. Ata nisën tē na trembin duke na kërcënuar me pushkët e tyre, e ne tē gjithë qentë sa ishim nē oborr, prapa telave me gjemba, nisën tē dilnim një nga një nēpér portën e madhe pér nē rrugë. Katallanët na vinin pas duke na kërcënuar me pushkë, e ne i kërcënonim me dhëmbë. Ecnim pak e ata na vinin pas. Shumë ishin ata me pushkë, e pak ishim ne me dhëmbë. Ndaleshim ne. Ndaleshin ata. Bënin ata një hap përpëra, ne iknim pak më larg. Ndaleshin ata, ndaleshim edhe ne. Kështu pér disa ditë. Kështu pér disa net.

Gjersa arritëm nē det.

SY ZEMRE...

S'e kam ndreq shtratin sot Nan',
 As teshat s'i kam palue.
 Emnin tem e shkrova
 N'krenën e pluhruerne t'pasqyrës..
 A thu ke me u mërzit n'mue?
 A ke me m'than se jam çik,
 E duhet me i ndreq punt e shpis,
 Se mysafiri t'brof pa lajms?
 E di Nan'!
 Sa her' qì gatis raftet n'odë t'gjumit,
 T'shoh n'bishi synit,
 E m'dukesh se po m'sheh.
 Du me i ba vedit me hile
 E me kry gjithçka si t'muj,
 E bash nj'aty t'i shoh duert,
 Nj'ashtu t'lmueme si kadife, tuj m'prek..
 Jo bij!
 Un' s't'kam msue kshtu,
 Je n'der t'huj tash, mos me m'korit!!
 Fill t'diftoj qysh me punue...
 Nana ish e verbën, n'mosh t're ke qorrue,
 Ani pse syt n'ball si bajshin drít,
 Ajo shpirtin e kish t'driuem.
 Ajo kish sy zemre,
 të mdhaj,
 Ma t'mdhajt qì kam ndij n'jet!..

E mblođha hinin
 e dashnisë sonë t'shkrumbueme,
 n'ji vazo balte
 pa mblojë.
 Natën,
 prej filadit
 qì tinëz
 çel dritaren,
 del tuj ladrue,
 e bahet
 xixlonjë....

Ka do dit'
 Qi vedin e kqyr
 Tuj hec rrugve t'qytetit
 Si nji skelet t'harkuem
 Pa pesh,e pa ngjyr.
 A ngi tash nata,
 Tuj m'kafshue
 Ka pak e pér çdo dit'.
 Kerrkush s'e kthen kryet,
 Kerrkush s'm'sheh,
 E s'di ma me than,
 A jam nji trup,
 A veç nji frym,
 Qi ecën n'rrethejake,
 Pa fun e krye.
 Po ka dhe do dit'
 Qi peshoj ma shum'
 Se gjysa e bots'.
 Jan' ditët kur
 Dillin e marr n'duer,
 Dhe e vej n'gjum n'qerpik.
 E syt' s'i çel
 Veç kur ta di,
 Se rrezen e tyne,
 Do e pushoј
 N'sy tu.
 E tuj m'shkit moti
 N'lëkur',
 Mbeta me syt' mbyll,
 N'errsir,
 Tuj prit me ndie
 Dhambit e preht
 T'natës,
 Qi s'din me u ndal...

Un' t'pash!
 N'tana dritat vezllue
 ke ftyra jote
 pa çehre.
 Me do rrath sysh
 Si rrath e tymit
 kur flaka përvlon pa ja nda.
 Un' t'pash!
 Kryqet ,kumbon n'shpin tande,
 dimnat qendis n'lëkur,
 nji sy i verbën pranvere
 Qi pikon gjak
 Tuj vadit
 Lulen e harrimit.
 Un' t'pash!
 E tehu i thiks
 ke ma i but
 se therja n'krahnorin tem.
 Me duert n'xhepa
 cingrrij monedhat,
 pér me ble nji grim frym...
 Un' t'pash...

Un' nuk menoj çdo dit' pér ty,
 Java m'shkon
 pa u ndie.
 N'rrugën teme
 s't'kam bashkudhtar,
 Gjith' veç me nji hije heci.
 Ti s'je,
 Kur teshat e shtratit
 I ndrroj n'sy t'dillit.
 S'je as n'bulza
 T'kafes,qi m'zgjon
 Pa i çel dita syt'
 Rrshket ndér lot
 T'vesës, e tretesh,
 Si kujtim i largt
 Sa nji jet'.
 Kur vedin e gjej
 Tuj bisidue me hijen teme,
 Qi s'm'dahet prej brinjsh
 Ti prap s'je!
 Po s'je as kur
 Hana m'fiket,
 As n'guralec t'bregut zemrës,
 Qi luejn n'dallgt e saj
 Her' tuj m'shpue,e her' tuj m'puth.
 N'notat e kangs shpirtit,
 Vargu yt asht fshi,
 A met that, heshtje mortore..
 Kurr nji tingull ma s'del.
 E n'fotografin ton pa ngjyr'
 Flen nji gri si thelb dimni.
 I kam rujt veç dy moll t'kuqe,
 Ja me t'amelzue,
 Ja me t'shti n'mkat.

Asht nji vend...
 Që mban do andrra...
 T'harlisuna n'sy shpirtash...
 Asht nji gj...
 Që mban nji flak..
 T'përzhitun n'hi yjsh..
 Asht nji vash..
 Që kep dhimtë e zemrës..
 Me fill ari t'flokve ujvarderdhun..
 Asht nji Natë..
 Që n'skuta t'jets fshehet..
 E dits ja merr edhe diellin e parë...
 Hiç pa i çel sytë..

Pshtillet moti...
 Don me ra shí..
 N'deg t'pemve..

Dy ketra..
 Luj'n e gjuhën..
 Grahin vrap..
 Tuj ndjek shoqi-shojn..
 Nji lajthi e gjet njani..
 E tjetri e kqyr kok'ul..
 Avitet,e i zgat duert..
 Lajthin me ja dhan..
 Me do sy qì shndrisin..
 N'vedi e afron..
 E ikin tuj ladrue..
 Nj'ashtu kadal,dimnin tuj e shtrue..
 Ndér deg' e flet' n'flet'..
 N'nji valle kettrash..
 E gat sa nji jet'..
 M'vjen ndërmend..
 Nji thagm nanash..
 Kur frnija lypshin me hangër pa ja nda..
 I shtrojshin ç'ka t'kishin..
 Me zort e me lezet..
 E nanat kqyrshin qjellin..
 N'dor t'Zotit, ka me mbajt dimën i ftuft simjet..

I kom pjek do g'shtenja t'vogla..
 I kom zgedh t'rrumullakta..
 Boj vjeshtore,t'ama..
 Qysh f'mij e kom rujt nji shami..
 T'qëndisun prej nan's, dy germa..
 N'te i kom pshtjell..
 Du me i rujt n'aty pér ty..
 Se druj se ik moti i tyne..
 E kur t'vish,m'etesh pa i provue..
 I kom grrith ka'pak..
 Me i ba ma t'urta n'zjerm..
 E n'çdo grith,kom shti pikla zemne...
 I kqyr me do sy t'mushun..
 I kom shpres',durim e vaj..
 E mbledh cepash shamine e çiknis'.
 Mbysh n'andrra dashnije n'pér skaj..

A sosun vaji i kanilit
 Ka jep shpirt
 N'grahma t'funit
 Flaka a met' sa grima
 Sa e zez' e thonit
 S'tfal nata
 T'perpi e t'ziton
 Krah shtrue
 E kur t'hupesh n'te
 Zor se kfjellesh.
 Ti s'ki me ardh
 E di
 Tash t'njoh mir'
 S'ma prish má
 Tymin e cingares.
 E llamba le t'shkimet
 Baj dhe pa drít'
 Ksaj bote t'rreme
 Me fruta t'kalbuna
 Veç nata ja mblon shëmtin...

Du me ta germëzue emnin...
 Du me ta thirr aq fort...
 Sa edhe t'dekunit me e ndie..
 M'andej me e shkrue..
 N'tana faqet e mureve t'mehallës...
 Me boj' t'gjakut...
 M'andej hyjt kam me mledh..
 E n'kup t'qjellës me i gatit...
 Qi emni yt me shndrrit...
 E n'mos u bindsh..
 Pér dashnin teme...
 Po t'diftoj..
 Se e kam skalit...
 Bash n'shpir...

JIM MORRISON

**ODE MBI LOS ANGJELOSIN
DERISA KUITOJ
BRIAN JONESIN, E NDJERË**

Jam banor qyteti
Sapo më zgjodhën të luaj rolin
e pricint të Danimarkës

E mjera Ofelia

Të gjitha ato hije që kurrë nuk i pa
Lundrojnë kismetit
në qiri të hekurt

Kthehu, luftëtar trim
Zhytu
në kanalin tjetër

Pishina apo e lyer me gjalpë
Ku është Marakeshi
Përposh ujëvarave
Stuhu e tërbuar

Ku të egërit bien
në pasditen e vonshme
Përbindësha ritmi

E ke lënë
Asgjënë tënde
të garojë me
Heshtjen

Shpresoj se ke dalë
Duke buzëqeshur
Si fërmijë
Në tepricën e freskët
të një endërrje

Njeri engjëll
me Gjarpërinj që luftojnë
për shuplakat
dhe gishtat e tij
Më në fund përvetësuan
Këtë shpirt
Zemërbardhë

Ofelia
Shkon, e mbështjellur
me mëndafsh

Endërr
e zbehur
Dëshmitar
i marrë i ngulfatur

Dërrasa për not, zhytja
Pishina

Ti ishe luftëtar
muzë e atllastë myshku

Ti ishe diell
i zbërdhulët
për pasdite televizive

zhabat
mbeturina të njollës së verdhë

Shih tash se ku të ka shpier
kjo

në qillin e tultë
me kanibale
dhe çifutë

Kopshtari
gjeti
trupin, e pafrenuar, Notonte

Kufomë fatbardhe

C'është kjo gjë e zbehtë e gjelbër
Nga e cila je punuar
Shpon bira në lëkurën e
Perëndeshës

A do të kundërmojë ai
Derisa bartet kah qilli
Nëpër hollet
e muzikës

S'ka gjasa.

Rekuim për të rendën
Atë buzëqeshje
Atë ngërdheshje satiri

Ka kërcyer përpjete
në tulinë



AH, SIKUR

Udhëkryqet
vend ku fantazmat
qendrojnë për t'iu përshpëritur
udhëtarëve në vesh dhe
për t'i bërë që të interesohen për
fatin e tyre

Autostopisti pi:
"Përsëri i thërras zotat e fshehtë
të errët të gjakut"
-----Pse na thërrët?
Ti e di çmimin tonë. Ai
kurrë s'ndryshon. Vdekja
jote do të t'japë jetë
dhe do të t'lirojë nga fati
i zi. Por po bëhet vonë.

-----Ah, sikur të kisha mundësi që t'ju shihja përsëri
dhe të flas me ju, dhe të shëtis
paksia në shoqërinë tuaj,
dhe t'pi pijen marramendëse
të bisedave tuaja,
mendova

-----të shpëtoj shpirtin tashmë
të rrënuar, të arrij çlodhje.
Të plackis arin e gjelbërt
në bastisjen pirate dhe të sjell
në kamp lavdinë e moçme.

-----Derisa njeriu me pelerinë shikon
brirët e helmuar dhe pi
fitoren e kuqe; ushtari
poashtu, me trofeun e tij,
helmetën e përshkuar; dhe
bartësi i viglës duke u dridhur
kërkon rrugën e tij përmirësinë e
tij të brendshme

-----(qeshje) Mirë pra, A do ta
përqeshje veten?

-----Jo.

-----Së shpejti zérat tanë duhet të bëhen
një, ose njëri prej nesh duhet të shkojë.

VARIACION MBI NJË POEZI TË DU FUSË

Dhembi kjo jetë. Kur hoqa dorë nga përpjekja
për të thënë ndryshe, ndihem i lehtësuar.
Shumë njerëz që dua janë në dhimbje të tilla.
Kur vjen pikëllimi, vjen

dhe s'ke ç'të bësh. E vërteta, thua?
Nuk vras mendjen të vishem me ditë të tëra.
Dje, pasqë atë pemë molle
në varrezat e vjetra hebreje.

Lulet ranë derisa kalonte një njeri,
duke fishkëlluar. Gurët shkëllgenin në rrezet e diellit.
Një gardh prej hekuri i ruante të vdekurit,
i mbante jashtë të gjallët. Nuk ka fjalë për të,

si rrezet e diellit shkëllqejnë në gardhin
që ndan të gjallët nga të vdekurit.

MË FAL BABA

Pse pij?
Që të mund të shkruej poezi.

Nganjëherë kur çdo gjë është e çthurrur
dhe çdo gjë e shëmtuar têrhiqet
në gjumë të thellë
Ndodh një zgjuarje
dhe çdo gjë që mbetet është e vërtetë.
Meqë trupi është i dërrmuar
shpirti bëhet më i fortë.

Më fal Baba sepse e di
ç'bëj.
Dua të dëgjoj Poezinë e fundit
të Poetit të mbramë.

Përktheu: Fadil Bajraj

Në shiritin e kohës

REGJISORI SERB NË TEATRIN “KOSOVA” TË TIRANËS

Në fund të shkurtit të vitit 1945, përderisa njësitë ushtarake shqiptare-jugosllave po bënë masakra mbi popullatën shqiptare në Maqedoni, Kosovë, Mal të Zi, Sanxhak e në Luginën e Preshevës, në Tiranë do të arrijë regjisori serb, Bozha Nikoliq, me qëllim që ta realizojë shfaqjen e parë profesionale teatrale në Shqipërinë komuniste




Shkëlzen HALIMI

Idila shqiptaro-jugosllave në prag të përfundimit të Luftë së Dytë Botërore dukshëm u reflektova edhe në bashkëpunimin kulturor. Autoritet e atëhershme komuniste të shtetit shqiptar, duke i respektuar në përpikëri parimet staliniste, kishin vendosur që edhe ndërtimi i kulturës të fillojë nga pika zero, prati krijohet kultura komuniste, e cila në fakt bëri prerjen më të vrashdë të kontinuitetit të kulturës shqiptare që kishte zënë fill sidomos në periudhën e Rilindjes Kombëtare, për të pasur një zhvillim të hovshëm në periudhën e Mbretit Zog, kur doli në pah një plejadë e intelektualëve me formim të shëndoshë kombëtar, e cila kishte një vizion të qartë për zhvillimin e gjithashëm të shtetit shqiptar, përfshirë edhe zhvillimin kulturor që në vitet 30-ta kishte filluar të lulëzojë përmes botimeve të shumta. Përveç këtë plejadë dhe këtë veprimitari të tyre komunistët shqiptarë do ta emërojnë si kulturë borgjeze e dekadente.

Në fund të shkurtit të vitit 1945, përderisa njësitë ushtarake shqiptare-jugosllave, po bënë masakra mbi popullatën shqiptare në Maqedoni, Kosovë, Mal të Zi, Sanxhak e në Luginën e Preshevës, krejt kjo në frymën e bashkim-vëllazërimit dhe eliminimit të atyre që ishin anti-komunistë, me kërkësë të palës shqiptare, ministri i atëhershëm i Republikës Federative Popullore të Jugosllavisë dhe shef i Agjitetit, Milovan Gjillas, do ta dërgojë në Tiranë regjisitorin Bozha Nikoliq, me qëllim që ta realizojë shfaqjen e parë profesionale teatrale në Shqipërinë komuniste, por edhe të ndihmojë në themelimin e Teatrit Popullor Shqiptar.

Që ironia të jetë edhe më e madhe, politikës së atëhershme komuniste shqiptare, fare nuk i pengoi që Bozha Nikoliqi ishte një individ i shkolluar në periudhën e Mbretërisë Jugosllave, kohë kjo në të cilën edhe kishte vepruar e punuar, por i cili nga pala serbe nuk ishte cilësuar si përfaqësues i kulturës borgjeze.

Në një deklaratë për gazeten “Bashkimi” (25 mars, 1945), me rastin e fillimit të organizimit të Teatrit shqiptar, Nikoliqi do të theksojë se “kam ardhur nga Jugosllavia mike që të ndihmoj në realizimin e idesë së udhëheqjes suaj për themelimin e teatrit popullor. Do të bëj përpjekje që t'u ndihmoj me përvojën që kemi pasur, sepse ne që moti i kemi kaluar vështirësitë nëpër të cilat po kaloni tani ju. Si kryetar shumëvjeçar i Shoqatës së Aktorëve, kam pasur rastin që të angazhohem në themelimin e shumë teatrove tona.... Udhëheqja



juaj e ka kuptuar rëndësinë edukative-kulturore të teatrit dhe e di se zhvillimi i vendit është i lidhur ngushtë edhe me zhvillimin e teatrit.

Edhe përkundër problemeve të shumta në procesin e sigurimit të kuadrit të nevojshëm, megjithatë më 4 qershor (1945) fillojnë provat e para për realizimin e shfaqjes DASHNORI (GJIDO), prova këto që, siç do të tregojë Nikoliqi në një raport (25 gusht, 1945) dërguar Ministrisë Shqiptare të Kulturës dhe Propagandës, do të zhvillohen me shumë probleme të natyrave të ndryshme. “Organizimi i teatrit

mori shumë kohë. Shumë anëtarë të këtij projekti ishin nga vende tjera të Shqipërisë, prandaj humbëm kohë derisa u tubuan të gjithë. Punët shkonin zvarrë, kurse unë e kisha bindur veten që të jem i durueshëm. Por, më në fund, më 4 qershor, filloi puna me aktorët”.

Në këtë shfaqje u angazhuan Mihail Popi, Ndoc Deda, Ndoc Meshkalla, Andon Panaj, Ndrekë Shkjezi, Hysni Pelinku, Gjon Karma, Lazar Popa, Matish Shiroka, Mihail Stefa, Besim Levonja, Mustafa Budini, Hasan Reçi, Nikolla Panajoti, Belul Hatibi, Ollga Shuraja, Martha Burda, Rica Dino, Etti Marku, Liza Vorfi, Beliye Çela, Andrea Malo, Prokop Mima - Naim Frashëri, Lazar Filipi, Nesti Spiro - Kostaq Taja, Kostandina Marango, Donika Burda, Ana Kçira, Xhevati Serezi, Qamil Grezda, Kolë Shala, Kadri Roshi, and others.

teatral që ruhen (në Arkivin e Beogradit) nën sinjaturën ACKSKJ, IX, 1/III - 36 dhe e mbajnë datën 25. III - 15. X. 1945, tregojnë se kësaj shfaqjeje, nga pushteti i atëhershëm popullor shqiptar, iu kushtua një vëmendje e veçantë. Kështu, siç njofton gazeta “Bashkimi” (29 shtator, 1945), me rastin e largimit të Bozha Nikoliqit nga Shqipëria, Xhemal Broja, atëherë kryeshef për kulturë, do të thotë se “Zoti Bozha Nikoliq nuk e kurseu fare veten që t'i japë hov teatrit në vendin tonë. Më përvojën e tij të madhe, ai u dha shumë aktorëve tanë, të cilët tani e qajnë largimin e tij”.

Nga këndi i nobelistit

SHPRESA KA MARRË FUND, ËSHTË ORA E VULLNETIT

Shkrimi i fundit i nobelistit Saramago, të cilin e kishte dërguar, pak para se të vdiste, për takimin ndërkombëtar të Pen Club Italia



Nga Jose SARAMAGO

Në Portugali është bërë një abuzim i madh me shkronjën e madhe. Në fjalimet politike, në gazetari, në ritualet e inaugurimeve gjelqjnë Idealet, Njerëzimi, Atdheu dhe Familja, Detyra, Zbulimet; e gjithë kjo me fraza të punuara dhe pompoze, sa më boshe aq më tingelluese. Ato fraza bartin të gjithë përbërësit e llomotitjes së tubimeve ose fjalimeve parlamentare. E në gojën e profesionistëve të fjalës bashkohet ndihma e vibracioneve bindëse, që shkojnë nga vezullimi i mëshirshëm deri te cijatja e fanfarës. Është një dhuratë për veshin mjeshtëror të orkestrimit. Është një mjerim përinteligjencën.

Tash, në qarkun e ideve, është shfaqur fjalë shpresë e ndjekur pas menjherë nga tundimi për ta fryrë shkronjën e parë duke e ndryshuar s-në në S. Është një veprim që ka të bëjë me magjinë, ashtu siç qe thënë se magjisë i përkisnin grafitët parahistorikë të shpellave. Duke e vënë shkronjën e madhe, është sikurse të lidhej më mirë shpresa e përbashkët me dëshirat tona të mëra. Merren sapuni për djathë, projekt për punë, ëndrra për realitet. E, meqë e tërë kjo duhet t'i ketë ndodhur tashmë Newton-it, të ulemi pra nën pëmën e mollës në prite të na bjerë molla mbi kokë në mënyrë që ta rizbulojmë, më fund, ligjin tonë të gravitetit.

Sic shihet, bëhet fjalë për një leksion për njerëz të mefshtë, që ende besojnë në shkencën pa prova. Tash, nga ky kënd imi fare pak i prirur kah iluzioni, zbulova se retori-ka nuk është shoqëri e denjë për

njerëz që dëshirojnë të mendojnë në mënyrë serioze dhe me trurin e vet. S'ka dyshim se askush (bash askush) nuk mund të lavdërohet se mendon në mënyrë unlike me kokën e vet. Me gjithë këto koka në botë, e të gjitha menduese, si të mos marrim material prej tyre për mendimin tonë? Thënë më mirë: e keqja e atyre që mendojnë me shkronja të mëdha është se ato shkronja të mëdha zënë shumë vend: gjysma e duzinës së tyre e mpnjnë dhe e bllokojnë krejtësisht ose përgjithmonë cilindo tru, edhe atë gjenial. Kjo bën që unë të jem njëmend armik i përbetuar i shkronjave të mëdha: më pëlqejnë (ja pral) fjalët, por do të doja t'i bëj shumë të vogla, në mënyrë që të mund të qëndrojnë edhe shumë të tjera aty.

E do të doja edhe të jenë të shpeshata, të mbushura me domethënë kuptim, aftësi veprimi. Nëse ulemi të themi dhe shkruajmë Shpresë, atëherë lamtumirë paralajmërimi tim. Biem në hulajën e mpirjes, në banjën e vakët, në litanitë zbutëse. Ndërkohë, realitetet do ta ndjekin rrugën e tyre, duke na tallur, nëse jo duke u shërbyer me ne. E në këtë rast listës së vajtimeve tona do t'u shnjë një zhgënjim të fundit. Mandej do të ulemi në pragun e shtëpisë ta shohim të sfilojë kortezhin e organizuar nga të tjerët duke e sjellë para ndërtësës sonë. Tash, jeta përbëhet nga shqetësimë të vogla e shumë të vogla. Njëra nga to është të shkruarit. Nga pikëpamja e Siriusit, as udhëtimi nga Toka në Hënë nuk fiton aq rëndësi. Por këtu, në sipërfaqen tokësore, vënia e një fjalë para tjetrës dhe posaçërisht në këtë birucë

të planetit, tregohet si një veprim shumë i rëndësishëm. Qoftë ai pozitiv a negativ. Do të jetë pozitiv nëse çdonjëra fjalë do të peshohet dhe matet, e rikthyer në vlerën e saj të vërtetë dhe jo e përdorur si perde gazi lotsjellës apo qasje në muzeun e antikave. Do të jetë pozitive nëse ngjall tek ai që lexon një jehonë të të mos vijë nga begenisja e errët e iluzionit dhe mashtimit që kotet në fundin e inercisë në të cilën kemi jetuar. Do të jetë pozitive nëse... E kështu me radhë, pa shpjegime të mëtejme. Pra, këtë fjalë shpresë, me ose pa shkronjë të madhe, është mirë ta fshijmë nga fjalori ynë. Sall të mërguarit dhe refugjatët, të nënshtruar nga ekzili dhe çatdhesimi, në mungesë të diçkaje më të mirë, duhet ta përdorin. Atyre u ofron ngushëllim dhe rehati. Të panënshtruarit kanë një fjalë tjetër më të saktë: vullnetin. Që, për më tepër, mund të shkruhet me shkronjë të madhe. Për këtë do të pajtohesha, nëse kjo mund të ndihmojë ndonjë gjë. E përfjalët do të mund të shtoja atë që veç e kam thënë në lidhje me këtë herave të tjera.

Këtu më ofrohet rasti ta rimarr një reflektim që pak a shumë thoshte kështu: fjalët janë të mira. Fjalët janë të këqija. Fjalët ofendojnë. Fjalët kërkojnë falje. Fjalët përvëlojnë. Fjalët miklojnë. Fjalët dhurohen, këmbohen, ofrohen, shiten dhe sajohen. Fjalët janë munguesse. Disa fjalë na thithin, nuk na lëshojnë, janë si këpushat: i gjemë në libra, në sloganë reklamash, në nëntituj, në fleta e afishe. Fjalët sugjerojnë, nxisin, urdhërojnë, imponojnë, përqojnë, eliminojnë. Janë të

lajkatare ose therëse. Bota sillet mbi fjalët e lyera me vaj durimi. Trurët blirojnë më fjalë në paqe dhe harmoni me fjalët e kundërtë e armike.

Kjo është arsyja pse njerëzit e bëjnë të kundërtën e asaj që e mendojnë, duke besuar se e mendojnë atë që e bëjnë. Ka shumë fjalë. Dhe ka fjalime të cilat janë fjalë të avitura njëra pranë tjetës në një ekuilibër ta pasigurt falë një sintakse të varfér, deri te përmbyllja finale e «Thashë» apo «Kam thënë». Me anën e fjalimeve celebrohet, inaugurohet, hapen dhe mbyllen tubimet, hidhet gaz lotsjellës apo bashkohen pëlhurat e mëndafshta. Janë dolli, fjalime, diskutime dhe konferanca. Përmes fjalimeve transmetohen elozhe, falënderime, programe dhe fantazi. E pastaj fjalët e fjalimeve duken të shtrira me kujdes në fleta, të piktuara me bojë tipografike dhe kështu hyjnë në pavdekësinë e Verbit. Pranë José Socrates \, president të asamblesë qëndron fjalimi që e ka hapur rubinetin e çezmës. E fjalët rrjedhin, rrjedhëse si «lëngu i çmueshëm». Rrjedhin të pandëprera, e vërsjoni dyshmenë, ngjiten deri te gjunjët, arrijnë deri te beli, supet, qafa. Është përmbytja universale, një kor i stonuar që ka vërvshuar nga miliona gojë. Toka e ndjek rrugën e vet në një potere të sapolindurish që cirren, ulërijnë, e mbështjellë edhe në një murmurimë të butë, të fashitur dhe pajtuese. Ka gjithçka mes koristëve: tenorë dhe tenorë të lehtë, basë, soprani me do të lehtë gjoksore, baritonë me zë të lartë, gjysmë kontraltë. Në intervale dëgjohet sugjerues. Dhe e gjithë kjo i huton yjet dhe i turbullon komunikimet, me shtrëngatat diellore. Ngase fjalët kanë pushuar së komunikuar.

Çdo fjalë është e shqiptuar gjersa të dëgjohet tjera. Fjala, edhe kur nuk pohon, pohohet. Fjala nuk përgjigjet, as nuk pyet: grumbullon. Fjala është bari i freskët dhe i gjelbër që i mbulon majat e mprehta të saksisë. Fjala është pluhur në sy dhe sy të shpuar. Fjala nuk zbulon. Fjala maskon. Për këtë lypset të zhvoshken fjalët derisa fara të shndërrohet në vjelje. Në mënyrë që fjalët të janë instrument i vdekjes ose shpëtimit. Në mënyrë që fjala të vlejë vetëm përatë që vlen heshtja e aktit. Është edhe heshtja. Heshtja, sipas definicionit, është ajo që nuk ndihet. Heshtja dëgjon, analizon, vrojton, mat dhe vlerëson. Heshtja është pjellore. Heshtja është toka e errët dhe fertile, humus i qenies, melodia e heshtur përposh drithës diellore. Mbi të bien fjalët. Të gjitha fjalët. Fjalët e mira e fjalët e këqija. Gruri dhe egja. Megjithatë, vetëm gruri e jep bukën.

(Përktheu: A. Idrizi)

LUFTA DHE POEZIA

(Reth librit "Sot eshtë një luftë tjetër" nga Lyudmyla Khersonska)

Nicole YURCABA

Në nivel global, poetët ukrainas po krijojnë poezinë ukrainase si një mekanizëm dekolonizimi brenda një kanuni të letërsisë globale të dominuar tradicionalist nga letërsia ruse. Nga ana tjetër, këta poetë e vendosin poezinë si mjet ruajtjeje për dokumentimin e sfidave të përditshme dhe brutalitetit të jetës gjatë kohës së luftës. Në librin "Sot eshtë një luftë tjetër" të Lyudmyla Khersonska, lexuesit ndeshen me një poete të përshtatur dhe të dashuruar me botën e gjallë dhe të aftë të dokumentojë shkatërrimin e luftës për shkak të lidhjes së tyre me rrethinat e tyre.

"Lufta. Dita 1" kap tronditjen dhe frikën e zgjimit ndaj një ekzistencë të shkatërruar rrënjoshtë nga një "mysafir - i paftuar dhe i frikshëm". Në të, një derë tingëllon,

"Mos e hap, mos e ushqeni atë dhe mos vishni fustanin tuaj të bukur. Nëse futet me forcë, goditeni me sëpatë."

Këto rreshta të thjeshtë i bëjnë jehonë tituve të tmerrshëm dhe artikujve të lajmeve që informojnë publikun për qëllimet e ushtarëve ruse në Ukrainë: të përdhunojnë, të gjymtojnë, të grabisin dhe të vrasin civilë. Poezia eshtë gjithashtu një testament i qëndresës ukrainase në një kohë të historisë kur edhe analistët më të mirë ushtarakë parashikuan një fitore të shpejtë ruse. Ndërsa "raketat këndonin jashtë dritares", poetët përkruan një grua që "u rrëzua nga shtreti me pizhame vishnjë". Gruaja thith dhunën që shpaloset - "bilbilin demonik", "njollén e kuqe, që fluturon jashtë dritares". Kaosi shpaloset, si dhe realiteti: "Pra, lufta eshtë këtu. Askush nuk e kërkoi një vizitë." Deklaratat janë pranim dhe njohje delikate e situatës, por nën pranimin, ekziston diçka tjetër - një vendosmëri në rritje për të mbijetuar.

"Ajo pyet, se ku janë iriset e mia" përkruan elementet e tmerrshme që kanë prishur jetën e përditshme. Fillimisht, lexohet si një poesi e thjeshtë - një grua pyet se ku kanë shkuar iriset e saj të dashur. Ajo merr një përgjigje:

"Ne i denazifikuam iriset tuaja, ato po përgatitnin një sulm, duke planifikuar për t'u bashkuar me BE dhe NATO, grumbullimi i bletëve biologjike."

Këto rreshta janë në qendër të poeziës. Kjo vendosje eshtë e domosdoshme jo vetëm në kontekstin e poeziës, por edhe brenda justifikimeve që Vladimir Putin ka përdorur për pushtimin e Ukrainës. Ai dhe mbështetësit e tij kanë theksuar se pushtimi i Ukrainës eshtë për të "denazifikuar" kombin. Rusia ka përhapur - mjافت efektivisht - teoritë e konspiracionit rreth biolab-eve të operuar nga SHBA në Ukrainë përgjatë kufijve ruse. Megjithatë, poetja kundërshton akuzat dhe poezië e Khersonskës shndërrrohet në një moment kundërshtimi dhe pranimi ukrainas se atë që Rusia kërkon të rimarrë, në fund e shkatërron.

"Muaji i katërt i granatimeve të

vazhdueshme" trajton një çeshtje që historiania ukrainase Olesya Khromeychuk e përkruan si "lodhje e Ukrainës". Në këtë poezi, poetja shprehet: "Eshtë në rregull të vrasësh dhe të shkatërrosh, thjesht jo në supermarket, stacionin tim të trenit". Fenomeni "lodhja e Ukrainës" ka lulëzuar dhe ka kontribuar në një rritje të ndjenjës anti-ukrainase. Megjithatë, poezia trajton me guxim izolacionizmin, i cili, në vende të tillë si Shtetet e Bashkuara, kontribuo në një rritje të ndjenjave djathtiste, anti-ukrainase. Poetja pohon:

"Anuloni qdo ligj dhe kushtetutë, fshijini të gjitha ato fjallë boshe, në drejta nekzistente nese nuk kemi të drejtë të jetojmë." Këto rreshta vënë në pikëpyjetë detyrim moral të vendeve si SHBA dhe Britania e Madhe, dy nga tre nënshkruesit e Memorandumit të Budapestit, i cili garantonte sigurinë për Ukrainën nëse Ukraina dorëzonte arsenalin e saj bërthamor.

"Ju jeni me vendin tuaj, kudo që të jeni" dëshmon për ndikimin e luftës mbi ukrainasit vendas dhe ata të diasporës. "Kudo që të jeni" thotë poetja, "ju dëgjoni bilbilat dhe goditjet (të çarat)." Ukrainasit vendas dhe diaspora iu përgjigjën luftës me një derdhje pikëllimi, avokimi, edukimi kulturor dhe me ndihma humanitarë dhe ushtarakë. Komunitetet globale ukrainase ndihmuani në kapërcimin e boshllëqeve kulturore për refugjatët. Diaspora krijoi platforma vokale (të zhurmashme), protestoi kundër luftës dhe u kërkoi qeverive të tyre të mbështesin Ukrainën. Megjithatë, fuqia e kësaj poezie nuk grumbullohet thjesht për shkak të peshës së saj emocionale të formuar nga shqyrtimi i përvojave të diasporës dhe refugjatëve. Poetja vëren se «fëmijët e vendit tim janë të qetë dhe shohin prindërit e tyre» dhe «fëmijët e vendit tim i paketojnë me nervozizëm gjërat e tyre». Poetja përkruan atë që durojnë fëmijët ukrainas:


"ata përgjedhin atë që kanë gjetur: copëza, plumba, një copë teli të ndryshkur,

gjithçka që "bota ruse" - që ata thonë se pjesë e të cilët eshtë vendi im të gjitha këto i dërgon në vendin tim nën mbulesën e ndihmës humanitarë."

Poetja i kthehet elementit të "denazifikimit" të prezantuar për herë të parë në "Ajo pyet, ku janë iriset e mia" dhe trajton një realitet fatkeq përfëmijët ukrainas që tanimë janë të njojur me armët e luftës më shumë sesa duhet.

"Sot eshtë një luftë tjetër" eshtë libër tronditës dhe këto poezi janë klithma beteje dhe dokumentare, vëzhgime dhe deklarata bashkëkohore. Koleksioni i këtyre poezeve u kujton lexuesve dhe botës botuese pse dekolonizimi i letërsisë dhe ngritja e zërave të shtypur eshtë imperativ në këtë pikë të historisë. (worldliteraturetoday.org)

Përktheu: Fitim Nuhiu



LYUDMYLA KHERSONSKA

Lyudmyla Khersonska ka lindur në Tiraspol, Moldavi, në vitin 1964. Ajo eshtë autore e dy librave me poezi, Vse svoi, i cilësuar si një nga dhjetë librat më të mirë me poezi të vitit 2011 dhe Tyl'naia-litsevaia (2015). Vepra e saj ka marrë disa çmime letrare dhe eshtë shpallur laureate dhe fituese e konkursit Voloshin. Poezitë e saj shfaqen në shumë revista, duke përfshirë Novyi mir, Znamia, Kreshchatik, Interpoesiia dhe Storony sveta, dhe janë përkthyer në gjuhën ukrainase, lituanisht dhe gjermanisht. Ajo ka bërë lexime poezish në Moskë, Kiev, Lviv, Munih dhe Nju Jork. Khersonska gjithashtu përkthen poetë në gjuhën angleze dhe në atë ruse, duke përfshirë Vladimir Nabokov dhe Seamus Heaney. Ajo ka folur për luftën e Rusisë në Ukrainë dhe ka lexuar disa herë poezinë e saj për luftën në Radio Liberty. Libri i saj i fundit, Tyl'naia-litsevaia, përfshin reflektim poetikë mbi agresionin rus në Ukrainë. Khersonska jeton në Odesa.

Çehovi ndryshe

NDËRMJET KREVATIT DHE DIVANIT

Shumë disidentë të epokës pas-staliniste e përmendnin Çehovin si mësues të tyre në jetë, si shkrimtar që u kishte dhënë dorë të ndërgjegjësosheshin për tërë tmerrin dhe gënjeshtren e pushtetit sovjetik

Viktor JEROFJEJV

Çehovi mbetet edhe sot njëri nga shkrimtarët më enigmatikë të letërsisë ruse. Sekreti i tij është se u përshtatet të gjithëve. U përshtatej të kuqve e të bardhëve, modernistëve e konservatorëve, ateistëve e fetarëve, moralistëve e cinikëve. Përpos kësaj, Çehovin e pranonjë dhe dy rryma tradicionalisht të papajtueshme të mendimit rus: properëndimorët dhe slavianofilët. Në këtë pikëpamje Çehovi vërtet nuk e ka shqipin. A mos vallë ngaqë është i epshëm si me qenë bish shelgu? Jo, ai nuk është i epshëm. Aspak i epshëm. As edhe nuk kohët më të ashpra staliniste veprat e shkruara nga Çehovi nuk përfundonin në gulagun letrar, ku kishin zënë vend edhe Demonët e Dostojevkit, traktatet fetare të Tolstoit e të Gogolit, si dhe vargjet erotike të Pushkinit. Teoricienit më të ngurtë të realizmit socialist e rekoman-donin Çehovin me cilësinë e shkrimtarit modern, krenoheshin me të si armik i mikroborgjezisë dhe si mik i Gorkit. Njëkohësisht, shumë disidentë të epokës pas-staliniste e përmendnin Çehovin si mësues të tyre në jetë, si shkrimtar që u kishte dhënë dorë të ndërgjegjësosheshin për tërë tmerrin dhe gënjeshtren e pushtetit sovjetik, duke u dhënë forca në luftën e vështirë me atë regjim.

Po se kthehemë prapa, në periudhën para revolucionit, edhe atje shihet pranimi në harmoni i Çehovit nga grupe letrare të ndryshme. Filozofi Lev Shevcov e përvëndoste Çehovin si këngëtar të dëshpërimit dhe, çfarë ishte tepër bujare për demaskuesin e vlerave të rreme, nuk e dyshonte për gënjeshtra morale, për çka e pati dyshuar, për shembull, Dostojevski. Çehovin e shihnin me sy të mirë dhe e përkëdhelin Merezhkovskij e Rozanovi. Madje, rrymat e skajshme të avangardës ruse, si futurizmi, nuk synonin dhe aq shumë "ta flaknin jashtë anijes së bashkëkohësisë".

Me përkëdheli e shohin Çehovin edhe jashtë vendit: gjithandej zunë ta përkthenin shumë dhe herët, në dhjetëra gjuhë. Mahniten nga stil, lakinizmi, impresionizmi, nga imtësitë në dukje të panevojshme (kurse në thelb tepër të nevojshme), sikush si të mundë. Në tabelën e renditjes e vënë shumë lart, në një radhë me më të mëdhenjtë. Në dramën çehoviane zbulojnë embrionin e teatrit të absurdit. Me Çehovin kanë mësuar gjuhën ruse breza të panumërt slavistësh. Shkurt: ai qe i dashur për të gjithë. Edhe shkrimtarët e brezit tim e çmojnë shumë.


Kurse, jo shumë kohë më parë, ihtarët e leksikut jonormativ e të shprehjeve të paturpshme u magjepsën nga Çehovi, kur në Pasqyrën letrare u botuan letrat e tij "erotike", të pabotuara deri më sot (sidoqoftë, edhe Çehovi paska patur gulum-hun e vet të vogël erotik). Në këto letra Çehovi na shfaqet si njohës dhe ihtarë i jetës seksuale, mburret me aventurat e veta në Japoni e në Ceilon, na jep imtësi ose thjesht hidhet në përsiatje për vështirësitë që hasen, kur do të bësh dashuri në divan - se në krevat paskësh genë ku e ku më e rehatshme. Dhe kur po

i lexoja këto përsiatje interesante për krevatin dhe divanin, të shkruara aq rrjedhshëm, me ironi e me shije nga njériu që nuk i skuqet faqja, zura të mendojë përsë Çehovi është i madh. Ai është i madh sepse thotë të vërtetën. Me të vërtetë, sikundër shkruan ai, "t'i bësh kollotumba një gruaje në krevat është më e rehatshme sesa në divan, i cili është ose tepër i butë, ose tepër i ngushtë - shkurt, i krijon mashkullit vetëm vështirësi".

Kjo që na thotë, nuk mbart ndonjë informacion të ri.

Epërsitë e krevatit kundrejt divanit i di çdo slavianofil a properëndimor; ato i dinë edhe në Francë, edhe në Argjentinë. Të gjithë, pa ngurruar fare, janë gati të pajtohen me mendimin e Çehovit. Mirëpo, tjetër gjë është të pajtohesh në mendim me tjetrin, tjetër gjë është t'i kushtosh vëmendje e ta pëershkuash me dorën tënde. Për këtë nuk mjafton as stili e as vëtëm talenti. Shkrimtarëve të tjerë u digjet shpirti për atë kohë. Ata janë të zënë dhe merren me shprehje mendimesh paradoksale, parapëlqejnë të thonë se, të flesh me femra në divan, është më e rehatshme se të biesh me to në krevat dhe se kjo tashmë është e pakuptueshme për cilindro postmodernizëm ose për diçka edhe më enigmatike se ky. Ata janë të zënë, kurse Çehovi është i lirë. Ai është shkrimtar i lirë. I lirë për të folur për gjërat më banale.

Më pati habitur kur, në një letër drejtuar dikujt, ai thoshte se mund të shkruante tregime për çfarëdoqoftë, madje edhe për një taketuke. Dhe më vjen keq që nuk ka shkruar për një gjë të tillë. Do të kishim pasur edhe një tjetër tregim çehovian nga më të bukurit. Ai me siguri do të kishte shkruar se taketukja shërbën për të hedhur aty hirin e cigares, sepse në këtë kuptimi taketukja është më e volitshme se porcelani i WC-së, ku bëjmë nevojën e bishtat e cigares rrinë e pluskojnë pa mundur kurrsesi të zbrresin deri në fund. Dhe të gjithë do të thoshin: Sa e vërtetë është kjo! Dhe po këta slavianofili, properëndimorë, francezë e kushdo tjetër, do të pajtoheshin në mendim me Çehovin, sepse është e vështirë të mos pajtohesh për këtë gjë. Po ashtu, është e vështirë të mos pajtohesh me mendimin e tij se idelet mikroborgjeze janë të mërzitshme, të neveritshme dhe të pamundshme për t'u shkulur me rrënje, se në stepa nuk gjen hije, kurse në male po, se njerëzit vanitozë janë të veckël e vulgarë, kurse të veckëlit e vulgarët - vanitozë, se ka femra me bukuri të përbindshme, por ka edhe dama të lezetshme me kone, me burra provincialë të mërzitshëm, të cilat shkojnë në vende klimaterike për pushime dhe u qëllon të flenë me burra pothuajse të panjohur, në krevat që dalin më të rehatshëm se divanet, por që prapës- prapë, pas kësaj, prishen nga nervat dhe ulen në tryesa me çehre mëkataresh, kurse burrat pothuajtë panjohur hanë me kënaqësi pasorgazmike shalqinjin e radhës. Sa e vërtetë! Sa e saktë! Sa e mërzitshme dhe e ëmbël të jetosh! Mirëpo, nga ana tjetër, nganjëherë të hipën t'i bësh "kollotumba" dikujt mu në divan, duke mos çarë kryet as për divanin, as për Çehovin, natyrisht.



NUMRI I ARDHSHËM MË 20 GUSHT

HEJZA

05 GUSHT, 2023

Kryeredaktor i Hejzës: **Avni Halimi** (avni65halimi@gmail.com)

Editon Produksioni **TAKAT STUDIOS**
Drejtor: **Genc Halimi** (genc@takat.tv)

Rruga e Kaçanikut nr. 208, Shkup, 1000